

VOTO 21.06.2015

RAPORTI VJETOR I KQZ-së



2015





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

R A P O R T

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2015

Tiranë, Shkurt 2016

PASQYRA E LËNDËS

KRIJIMI: PËRBËRJA; PËRGJEGJËSITË, MANDATI, DETYRAT DHE FUNKSIONET E KQZ

3

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 21.06.2015

I. PJESA E PARË – PERIUDHA PARAZGJEDHORE	4
I.1 VEPRIMTARIA e KQZ-së për ndryshimet në Kodin Zgjedhor si rezultat i reformës administrative-territoriale, etj	4
I.2 PLANI ORIENTUES I VEPRIMEVE	4
I.3 AKTE TË KQZ-së	5
I.4 BASHKËPUNIMI i KQZ-së me organet e qeverisjes vendore, marrja e informacionit për qv-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, qv-të në ambiente private	8
I.5 BUXHETI DHE FONDET	10
I.5.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2015	10
I.5.2 Buxheti i KQZ-së për zgjedhjet	10
I.5.3 Financimi i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në zgjedhje dhe të Partive Politike për vitin kalendarik 2015	11
I.6 PLANIFIKIMI	13
I.6.1 Logjistika zgjedhore	13
I.6.2 Burimet Njerëzore në KQZ	14
I.6.3 Prokurimet	16
I.7 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE	16
I.7.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore	16
I.7.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve	17
I.7.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve	19
I.7.4 Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve	20
I.8 TRAJNIMET	20
I.8.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve	20
I.8.2 Zhvillimi i trajnimit	21
I.9 INFORMIMI	23
I.8.1 Edukimi i votuesve	23
I.8.2 Shoqëria	26
I.10 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE	27
I.10.1 Regjistrimi i partive politike: koalicionet	27
I.10.2 Regjistrimi i votuesve	29
I.10.3 Ankimimet për procesin e regjistrimit	30
II PJESA E DYTE – PERIUDHA ZGJEDHORE	31
II.1 Akreditimi i vëzhguesve	31
II.2 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit	32
II.3 Aksesi i medias	33

II.4	Fleta e Votimit	34
II.5	Përgatitja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KQV	36
II.6	Dita e zgjedhjeve	36
II.7	Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së	37
II.8	Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ	37
II.9	Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar	39
II.10	Ankimet për rezultatet	40
	III PJESA III – PERIUDHA PASZGJEDHORE	42
III.1	Auditimi i subjekteve zgjedhore	42
III.2	Analiza e zgjedhjeve	43
III.3	Strategji për të ardhmen	43
III.4	Sugjerime për përmirësime në Kodin Zgjedhor, nisur nga problematikat e hasura në zgjedhje	45
	IV VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË	46
IV.1	Marrëdhëniet me institucionet e tjera	46
IV.2	Partneriteti, KQZ-Organizma Ndërkombëtare	47
IV.2.1	Vëzhgimi i proceseve zgjedhore	48
IV.2.2	Përfaqësimi i KQZ-së në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore	48
IV.2.3	Konferenca e 25-të e ACEEEO, shtator 2016, Tiranë	49

PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË, MANDATI, DETYRAT DHE FUNKSIONET E KQZ

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga shtatë anëtarë të gjithë të miratuar nga Parlamenti, ku tre anëtarë janë të propozuar nga maxhoranca parlamentare dhe tre të tjerë nga opozita dhe që shërbejnë për një periudhë kohore 6 (gjashtë) vjeçare. Kryetari emërohet për një periudhë katër vjeçare pas ndjekjes së një procesi të hapur rekrutimi. Të gjithë anëtarët janë nën betim për të respektuar ligjin dhe ruajtur pavarësinë.

KQZ është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve me synim garantimin dhe respektimin e parimeve, të drejtave, garancive kushtetuese dhe ligjore në zhvillimin e zgjedhjeve.

Në realizimin e qëllimit të mësipërm, KQZ i përmbahet :

- Zbatimit korrekt dhe me përgjegjshmëri të plotë të normave kushtetuese dhe ligjore në organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve,
- Përhapjes dhe konsolidimit të një kulture të re zgjedhore tek zgjedhësit, nëpërmjet fushatave të vazhdueshme të edukimit qytetar,
- Rritjes së kapaciteteve dhe performancës së komisionerëve të komisioneve zgjedhore, nëpërmjet trajnimeve cilësore, profesionale dhe periodike,
- Rritjen e kontrollit dhe transparencës së financimit të fushatave zgjedhore,
- Nxitjen e reformave ligjore për përmirësimin e legjisllacionit zgjedhor.

KQZ aspiron arritjen dhe respektimin e plotë pa asnjë kompromis të standardeve për realizimin e zgjedhjeve të lira të drejta dhe demokratike, në përputhje me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe ligjet e tjera, për të mbrojtur integritetin dhe fshehtësinë e votës, duke kontribuar në konsolidimin e demokracisë në procesin zgjedhor.

KQZ, në veprimtarinë e saj ka detyrimin të garantojë dhe të transmetojë vlerat, si: ndershmëria, paanësia, pavarësia, transparenca, besueshmëria dhe shërbimi drejt qytetarit. Këto vlera shërbejnë për realizimin e drejtimeve strategjike të KQZ-së, si:

- Organizimi i një procesi zgjedhor i aksesueshëm dhe eficient,
- Rezultate votimi transparente, të besueshme dhe në kohë reale,
- Ndërgjegjësim të votuesve dhe informim cilësor të tyre,
- Përmirësim i performancës dhe kapaciteteve të institucionit.

dhe objektivat kyçe

- 1- Forcimi i kapaciteteve institucionale të KQZ-së dhe të organeve të administratës zgjedhore;
- 2- Ofrimi i ndihmës së nevojshme në kuadër të përfundimit me sukses të reformës zgjedhore, me synim realizimin e zgjedhjeve vendore dhe parlamentare, të lira e të drejta, në përputhje me standardet evropiane;
- 3- Rritja e mëtejshme e pavarësisë së administratës zgjedhore në të gjitha nivelet;
- 4- Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës së veprimeve të KQZ-së;
- 5- Marrja e masave për të siguruar botimin e akteve të KQZ-së në kohën e duhur;
- 6- Përmirësimin e kuadrit nënligjor ekzistues dhe hartimin e akteve nënligjore të reja për rregullimin e proceseve zgjedhore, në përputhje me normat ligjore dhe me standardet evropiane;
- 7- Përmirësimin e vazhdueshëm të mjeteve të komunikimit midis administratës zgjedhore dhe qytetarëve.

KQZ, referuar nenit 21, pika 13 të Kodit Zgjedhor paraqet në Kuvend brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor për veprimtarin e vitit të kaluar dhe, nisur nga fakti se vitin e kaluar, KQZ organizoi zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015, raporti të cilin po paraqesim përpara Kuvendit ka sqaruar në mënyrë të detajuar, çdo aspekt që ka lidhje me organizimin dhe zhvillimin e këtyre zgjedhjeve.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 21.06.2015

I. PJESA E PARË – PERIUDHA PARAZGJEDHORE

I.1 Veprimtaria e KQZ-së për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, si rezultat i reformës administrativo-territoriale etj.

Pas zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013, siç kemi informuar dhe më parë, KQZ nëpërmjet organizimit të diskutimeve në disa tryeza teknike formuloi një sërë propozimesh për përmirësime në Kodin Zgjedhor dhe ia përcolli zyrtarisht Kuvendit të Shqipërisë. Këto propozime mbështeteshin kryesisht në rekomandimet e raporteve të misioneve të vëzhgimit të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2011 e 2013, si dhe nga përvoja në veprimtarinë e KQZ-së Gjithashtu, KQZ ndoqi me vëmendje procesin e reformës administrative-territoriale që ndërmoi Kuvendi dhe me miratimin e ligjit përkatës draftoi të gjithë ndryshimet e mundshme teknike në Kodin Zgjedhor, që vinin si domosdoshmëri e ndarjes së re administrative-territoriale. Në momentin që dy grupe deputetësh ndërmorën iniciativa ligjore për përmirësime të Kodit Zgjedhor, KQZ bashkëpunoi me Komisionin e Ligjeve dhe dha kontributin e vet teknik për përgatitjen e amendimeve të Kodit Zgjedhor. Propozimet e bëra ishin në dy drejtime kryesore, ndryshime që vinin si domosdoshmëri e përshtatjes me ndarjen administrative-territoriale dhe ndryshime për përmirësimin e treguesve gjinor në zgjedhjen e organeve përfaqësuese të pushtetit vendor. Me këtë rast falenderojmë deputetët e grupeve iniciuese për ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe Komisionin e Ligjeve që u treguan bashkëpunues dhe arritën të përfshijnë pothuaj të gjitha propozimet e bëra nga KQZ.

I.2 Plani Orientues i Veprimeve

KQZ, me nxjerrjen e Dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015, në kuadër të detyrimeve ligjore që ka, lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, me vendimin përkatës miratoi një plan orientues veprimesh. Plani Orientues i Veprimeve ishte një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore mbi të cilat u mbështet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së. Plani Orientues i veprimeve parashikoi jo vetëm çdo akt nënligjor, të cilin KQZ, duhet ta nxjerë në zbatim të Kodit Zgjedhor (vendime, udhëzime, akte të thjeshta dhe akte normative), por dhe akte nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhënie të caktuara për herë të parë, si pasojë e ndryshimeve në ligj apo praktikën e mëparshme zgjedhore apo rekomandimet e OSBE/ODIHR, që diktuan nevojën për ndryshime dhe shtesa. Veprimet që parashikohen në këtë plan, burojnë nga detyrimet e përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe janë zbatimi i tyre në praktikë.

Detajimi i veprimeve konkrete dhe i afateve kohore, brenda të cilave këto veprime duhet të ndërmerren, duke iu referuar përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor ndihmuan KQZ-në të kontrollojë në çdo moment ecurinë normale të këtij procesi zgjedhor, ndihmuan partitë politike, vëzhguesit e huaj dhe vendas të orientoheshin në realizimin e procedurave dhe njëkohësisht të kontrollonin ecurinë e procesit dhe të veprimtarisë së KQZ-së.

I.3 Akte të KQZ-së

Në zbatim të kompetencave ligjore, përcaktuar në Kodin Zgjedhor, KQZ për administrimin e procesit zgjedhor ka nxjerrë gjithsej (969) vendime dhe 5 udhëzime.

Udhëzime,

Udhëzimet e miratuara nga KQZ gjatë vitit 2015, (5 udhëzime të reja dhe rishikimi i një udhëzim të vitit 2009), si pasojë e ndryshimeve të bëra nga Kodi Zgjedhor me ligjin nr.31/2015, datë 19.07.2012, i ndryshuar apo e diktuar nga nevojat e përligjura të lindura nga zgjedhjet e kaluara, përcaktuan në mënyrë të qartë të gjitha procedurat që do të ndiqeshin prej subjekteve zgjedhore, si dhe komisioneve të niveleve të dyta dhe të treta, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë zgjedhor, administrimit transparent të tij, si dhe të barazisë për të gjithë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në të.

Këto udhëzime të reja që u miratuan, jo vetëm shfuqizuan aktet e mëparshme, plotësuan kuadrin nënligjor udhëzues për KZAZ-të, KQV-të dhe GN-të, në përputhje me ligjin zgjedhor, por realizuan dhe dhënien e instruksioneve sa më të qarta dhe të detajuara për kryerjen me profesionalizëm të detyrave dhe procedurave që Kodi Zgjedhor përcakton si kompetencë të administratës së nivelit të dytë dhe të tretë. Njëherazi këto udhëzime, do t'i shërbejnë të gjitha llojeve të zgjedhjeve, në përputhje me vetë karakterin që duhet të ketë akti normues, dhe duke realizuar kështu urdhërimin e Kodit Zgjedhor që aktet normuese, si rregull, shërbejnë për të gjitha llojet e zgjedhjeve.

Më konkretisht këto udhëzime kanë rregulluar marrëdhënie të tilla, si:

- Organizimi dhe Funksonimi i Zyrave Rajonale Zgjedhore; Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor; Komisionit të Qendrës së Votimit dhe Grupit të Numërimit (në të cilat përcaktohen norma sjellje për një numër të konsiderueshëm dhe të rëndësishëm procedurash, u shtjelluan në mënyrë të detajuar roli dhe detyrat e komisionerëve zgjedhor, radhën e veprimeve, si dhe instruksionet për marrëdhëniet juridike të trajtuara në to, u pasuruan nëpërmjet elementëve të rinj si përgjegjësitë e gjithsecilit anëtar, sanksionet administrative në rast të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale).
- Mbledhja, administrimi dhe publikimi i rezultatit paraprak të zgjedhjeve.
- Mënyra e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit.
- Procedurat e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
- Mënyra e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit (në të cilin u detajuan rregulla për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për sipërfaqen e objekteve në korelacion me numrin e qendrave të votimit, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit të Votave në varësi të numrit të qendrave të votimit, si dhe rregullat për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave).
- Detyrat e policisë së shtetit në zgjedhje (ku u formalizua modeli i vendimit që do të përdorte KZAZ-ja për thirrjen/largimin e punonjësit të policisë së shtetit në VNV në rastet kur rrezikohej rendi dhe qetësia. Këto modele vendimesh, jo vetëm i shërbenin unifikimit të praktikave zgjedhore, por gjithashtu rregullonin marrëdhënien mes Policisë së Shtetit dhe administratës zgjedhore).

Aktet normuese të miratuara nga KQZ, u vlerësuan nga komisionet zgjedhore si një paketë e plotë nënligjore, me instruksione dhe udhëzime të qarta në funksion të përmbushjes korrekte të detyrave.

VENDIME


KQZ ka miratuar 969 vendime për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.

Nga 969 vendimet e miratuara

- 840 vendime janë marrë me 7 vota pro;
- 22 vendime janë marrë me 5 vota pro dhe 2 kundër;
- 30 vendime janë marrë me 4 vota pro dhe 3 kundër;
- 61 vendime janë marrë me 6 vota pro dhe 1 kundër;
- 16 vendime janë marrë me 4 vota pro dhe asnjë kundër (në detyrë ishin 4 anëtar të KQZ-së)

Vendimet e KQZ janë të vlefshme kur votojnë pro shumica e anëtarëve të saj me përjashtim të disa vendimeve të shprehura në mënyrë shteruese nga Kodi Zgjedhor, miratimi i të cilave kërkon votën pro të shumicës së cilësuar, të 5 anëtarëve. Ky është i vetmi përcaktim ligjor për vlefshmërinë e vendimeve të KQZ. Sigurisht, në afro 900 vendime, 840 nga këto, janë votuar me 7 vota pro, 22 vendime, që janë votuar me 5 vota pro dhe 2 kundër dhe 37 vendime, janë votuar me 4 pro dhe me 3 kundër.

Grafiku i miratimit të vendimeve 2015



Në raport me objektin e këtyre vendimeve, pjesa më e madhe e tyre ka shërbyer për:

- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore në KQZ (regjistrimin e partive politike, kandidatëve për Kryetar Bashkie dhe listave shumëmemërore për 10 bashki, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit);
- Miratimin e modeleve të kandidimit;
- Miratimin e dokumentacionit të punës të komisioneve të niveleve të dyta e të treta;
- Miratimin e manualeve zgjedhore;
- Emërime dhe zëvendësime të komisionerëve zgjedhorë (101 prej të cilëve me objekt lirim-emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ sipas kërkesave të partive politike);

- Miratimin e modeleve të materialeve zgjedhore;
- Monitorimin e fushatës zgjedhore në media;
- Miratimin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit;
- Miratimin e vëzhguesve vendorë apo të huaj;
- Marrjen e masave administrative në raste të caktuara (vendosja e sanksioneve administrative ndaj disa kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore);
- Nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve për 10 bashkitë e mëdha të cilat administrohen nga më shumë se 1 ZAZ;
- Përllogaritja e mandateve dhe ndarja e tyre për çdo subjekt zgjedhor për 61 Këshillat Bashkiak;
- Vendime për shqyrtimin e kërkesave ankimore.

Akte me karakter organizativ dhe ekzekutues, synuan qasjen në formë dhe përmbajtje sa më lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme nga administrata zgjedhore, me qëllim shfrytëzimin e çdo mundësie për të sjellë ligjin zgjedhor në vëmendje të çdo komisioneri gjatë përmbushjes së detyrës. Në dokumentet e punës u cituan dispozitat ligjore përkatëse nga buronte detyrimi dhe përgjegjësia për kryerjen e veprimtarisë.

Draftimi i akteve/dokumenteve të rëndësishme për procesin, si strategjia për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, manualët e trajnimit, strategjia për edukimin zgjedhor të shtetasve, patën një vëmendje të madhe për vetë rëndësinë e tyre, duke synuar, mbi bazën e eksperiencës "së administruar", rritjen profesionale dhe cilësore.

Rregullorja "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KQZ-së".

KQZ referuar nenit 21, pika 25 të Kodit Zgjedhor, ka detyrimin e miratimit të Rregullores "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KQZ-së". Pas miratimit të Kodit të ri Zgjedhor në vitin 2008, rregullorja në fuqi "Për organizimin dhe funksionimin e KQZ-së" si akt nënligjor i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor të shfuqizuar, u shfuqizua.

Projekti i rregullores së paraqitur për miratim në KQZ në muajin mars të vitit 2013, nuk u miratua, për shkak të mosgjatjes së kompromisit për projektin e paraqitur. Më pas duke qenë në kushtet e pamundësisë së miratimit të saj, për mungesë kuorumi të nevojshëm që kërkon miratimi i këtij akti, KQZ ishte parregullore deri në vitin 2015. Që prej vitit 2008, KQZ i referohej, për sa kjo ishte e mundur, Rregullores së vjetër.

Në vitin 2015 si rezultat dhe i mbështetjes dhe bashkëpunimit me KE, OSBE dhe ekspertë të Komisionit të Venecias, KQZ e plotësuar tashmë me 7 anëtarë, miratoi me konsensus rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.95, datë 08.04.2015.

Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e KQZ-së ka për qëllim të rregullojë aspekte të tilla si:

- a) kompetencat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së;*
- b) të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të KQZ-së;*
- c) rregullimin e marrëdhënieve të administratës me anëtarët e KQZ-së;*
- d) procedurat për thirrjen, njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të KQZ-së gjatë periudhës zgjedhore dhe asaj jozgjedhore;*

- e) procedurat e vendimmarrjes në KQZ-së;
- f) të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në KQZ;
- g) procedurat e vendimmarrjes për administrimin e financimeve të aktivitetit të KQZ-së, etj.

I.4 Bashkëpunimi i KQZ-së me organet e qeverisjes vendore, marrja e informacionit për QV-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, QV-të në ambiente private.

Kodi Zgjedhor përcakton detyra të rëndësishme për organet e qeverisjes vendore, në funksion të administrimit të zgjedhjeve. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ka detyrimin për të caktuar vendndodhjen e qendrave të votimit, krijimin e një QV-je shtesë kur një zonë QV-je ka më shumë se 1000 zgjedhës dhe bashkimin me një zonë tjetër QV-je të një zone QV-je që ka më pak se 200 zgjedhës, përgatitjen e hartës zgjedhore për çdo zonë qendre votimi, propozimin e KQZ-së për të miratuar qendra votimi në ambiente private sipas kritereve që përcakton KQZ me akt normativ, etj.

Afati kohor për ushtrimin e këtyre kompetencave përfundon me përgatitjen e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë. KQZ me Udhëzimin Nr.1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet", ka përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe afatet e realizimit të tyre nga këto njësi.

Në vlerësim të rëndësisë së realizimit në kohë dhe në përputhje me standardet e kërkuara ligjore të këtij procesi, KQZ fillimisht adresoi shkresërisht e më pas publikisht, në mënyrë të detajuar dhe përsëritur, kërkesën për dërgimin e të dhënave të kërkuara nga ligji. Për më tepër, në rolin e saj bashkëpunues, KQZ ofroi asistencë permanente për mënyrën e përgatitjes dhe plotësimin e të dhënave gjatë gjithë këtij procesi.

KQZ në mbështetje të nenit 169, nenit 171 pika 1, të Kodit Zgjedhor vendosi sanksione administrative me gjobë për 31 kryetarë të njësisë të organeve të qeverisjes vendore të cilët nuk zbatuan dispozitat e Kodit Zgjedhor. Megjithëse në tejkallim të afatit ligjor KQZ, në vlerësim të shqetësimeve të ngritura nga subjektet zgjedhore për sa i përket plotësimin të kritereve ligjore për vendndodhjen e disa QV-ve, si dhe pas verifikimeve të pretendimeve të ngritura, disponoi me vendimet përkatëse ndryshimin e vendndodhjeve të një numri jo të vogël qendrash votimi.

141 Kryetarë të NJQV përcaktonin vendndodhjet e 481 QV-ve në ambiente private (389 QV në të njëjtën adresë me zgjedhjet e fundit dhe 92 QV me adresë të ndryshme). Në asnjë rast, nuk referoheshin të dhënat e kërkuara në kuptim të përcaktimeve të nenit 93 të Kodit Zgjedhor, si:

- Pamundësia për të përdorur ndërtesa publike në territorin e QV-së, ose në territorin e zonës së votimit fqinj;
- Nuk paraqitej propozim për dy objekte alternative private, ose pamundësi të përcaktimit të tyre.
- Për objektet e propozuara nuk dërgohej dokumentacioni i kërkuar: planimetritë përkatëse, foto, si dhe nuk referoheshin të dhëna për pronarët e objekteve, sikundër përcaktohet në nenin 93, pika 2 të Kodit Zgjedhor.
- Në katër raste, propozohej caktimi i vendndodhjes së QV-së në banesa private, në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor.

Për përmbushjen e kërkesave ligjore, KQZ-ja riadresi 141 shkresa duke cituar dhe qartësuar

sërish përcaktimet dhe përgjegjësitë ligjore në rast të mosdërgimit të plotë dhe në afat të informacionit.

Në përgjigje, vendndodhja e 19 QV-ve u caktua në ndërtesa publike, por nuk munguan rastet e qëndrimeve/interpretimeve joligjore duke u justifikuar me mosndryshimin e vendndodhjes në ndërtesë private të QV-së, si të bazuar në nenin 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor, apo duke pretenduar se të dhënat janë dërguar në vitin 2013.

Nga 462 QV, të propozuara fillimisht për t'u caktuar në ndërtesa private, (4 prej të cilave në banesa private), KQZ-ja miratoi vendndodhje në ambiente private për 433 prej tyre, dhe në asnjë rast në shtëpi banimi. Për 29 prej tyre, KQZ caktoi vendndodhjen në ambiente publike (shkolla dhe ambulanca), pasi në ndryshim nga sa kishin informuar kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, egzistonin mundësitë për caktimin e tyre në ambiente publike.

Në periudhën 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, periudhë për të cilën Kodi Zgjedhor përcakton se vendndodhja e QV-së mund të ndryshojë vetëm për shkak të forcave madhore, nga Kryetarët e Njësive të Qeverisjes Vendore, u kërkua dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes për 84 QV, 25 prej të cilave me vendndodhje në ndërtesa publike. Arsyet e paraqitura, dëshmuuan për neglizhencë nga ana e Kryetarëve të Njësive të Qeverisjes Vendore për të marrë informacion të plotë dhe të saktë për disponibilitetin për ditën e zgjedhjeve të objekteve të propozuara për QV¹.

KQZ, autorizoi ndryshimin e vendndodhjeve të 54 QV-ve, dhe nuk miratoi ndryshimin e vendndodhjes për 30 QV.


Të gjitha vendimet e KQZ-së për miratimin e qendrave të votimit në ambiente private, apo dhe për dhënien e autorizimit për ndryshim vendndodhje i janë komunikuar menjëherë shkresërisht dhe në mënyrë elektronike, kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore respektive, duke urdhëruar kryerjen e menjëhershme të lajmërimeve të zgjedhësve të këtyre qendrave të votimit.

Problematika të këtij procesi:

- Mungesa e përgjegjshmërisë së Kryetarëve të Njësive të Qeverisjes Vendore në dhënien e informacionit, edhe për mosnjohje apo moskuptim të ligjit zgjedhor;
- Përfaqësuesit e partive politike konsumojnë shumë kohë për konsultimin e materialit, dhe verifikimin e të dhënave;
- Pamundësia e verifikimit nëpërmjet inspektimit, të pretendimeve për lidhjet fisnore të pronarëve të ndërtesave private me përfaqësues së partive politike;

Pavarësisht problematikave të referuara, grafiku dëshmon një trend në ulje të numrit të QV-ve të caktuara në ambiente private.

¹ Arsyet e paraqitura ishin të tipologjive :- Rikonstruksion ose ndryshim destinacioni; pronarët e ambienteve nuk pranojnë vënien e objektit në dispozicion për QV; mosplotësim i kushteve (për QV-të në ndërtesa publike).



I.5 BUXHETI DHE FONDET

1.5.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2015

Për vitin 2015, KQZ-së iu vunë në dispozicion 92,800 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" për shpenzimet e administratës për paga dhe sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime si edhe për shpenzime kapitale.

Në zbatim të buxhetit të akorduar u realizuan procedurat prokuruese për sigurimin e bazës materiale për funksionimin e institucionit, konform legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike.

Me vendimin nr.108, datë 04.02.2015, Këshilli i Ministrave miratoi "Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015", për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e rikonstruksionit të godinës së re të KQZ-së", fondin prej 57 937 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh. Fondet, të cilat u çelën nga Ministria e Financave, u prokuruan nga KQZ dhe në përfundim u realizua rikonstruksioni i godinës së re, ku është vendosur dhe po kryen veprimtarinë e tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

1.5.2 Buxheti i KQZ për zgjedhjet

Me ligjin nr.160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 600 milionë lekësh për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.28, datë 20.02.2015 "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015" miratoi projektbuxhetin për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015, duke parashikuar një strukturë buxhetore në shumën totale prej 738 milionë lekë, (nr.zgjedhësve 3.382.295) me kosto për një votues rreth 1.6 euro.

KQZ-ja e motivuar për ruajtjen dhe përmirësimin e standarteve zgjedhore, eliminimin e të gjitha dobësive potenciale që mund të shkaktohen gjatë një procesi zgjedhor për shkaqe ekonomiko-financiare, kërkoi shtesë fondi në programin e zgjedhjeve, shtesë e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.447, datë 27.05.2015 "Për një shtesë fondi në

buxhetin e vitit 2015, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe financimin e partive pjesëmarrëse në këto zgjedhje”, në shumën 138 milion lekë.

Duke analizuar strukturën buxhetore të zgjedhjeve të përgjithshme rezulton se 7.74 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore të personelit të përkohshëm, 29.48 % e fondit është akorduar për pagesën e komisionerëve të të gjitha niveleve, 62.78 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 738 milionë lekë të akorduara, u realizuan 676 milionë lekë ose 91.6% e fondeve të akorduara. Diferenca prej 62 milionë lekësh konsiston në 4.3 milionë lekë në zërin paga për personelin e përkohshëm, dhe 49 milionë lekë në zërin shpenzime për mallra dhe shërbime.

Tabela e fondeve buxhetore të parashikuara dhe realizuara-zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, 2015

	<u>paga</u>	<u>sigurime</u>	<u>shperblime</u>	<u>mallra/sherbime</u>	<u>ne mije/leke</u>
-					<u>totali</u>
fondet e parashikuara	48,940	8,000	213,060	468,000	738,000
fondet e realizuara	41,081	6,862	210,571	418,221	676,735

1.5.3 Financimi i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në zgjedhje dhe të Partive Politike për vitin kalendarik 2015

Neni 87/1 i Kodit Zgjedhor përcakton se subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, financohen nga fonde publike dhe jopublike. Fondet publike për këtë qëllim vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe ndahen me vendim të KQZ sipas formulës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Për fushatën zgjedhore, zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015, Këshilli i Ministrave me VKM nr.447, datë 27.05.2015 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për KQZ, për organizimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe financimin e partive pjesëmarrëse në këto zgjedhje”, akordoi shumën prej 65 milionë lekësh për t’iu shpërndarë subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje. KQZ shpërndau fondin prej 65 milionë lekësh, partive pjesëmarrëse në zgjedhje me vendimin nr.612, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015”, bazuar në përcaktimet e nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor (**shiko tab 1, Aneks 1**).

Me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, fondi prej 65 milionë lekësh u rishpërnda nga KQZ me vendimin nr.967, datë 10.08.2015 “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015” (**shiko tab 2, Aneks 1**)

Për ushtrimin e aktivitetit normal të tyre, partitë politike financohen nga buxheti i shtetit. Ligji për partitë politike ngarkon KQZ-së të përcaktojë masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Ligji nr.160/2015, datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015", parashikoi fondin prej 190 milionë lekësh si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2015.

Neni 19, pika 2 e Ligjit "Për partitë politike", i ndryshuar, përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;

b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare;

c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

KQZ me vendimin nr.23, datë 03.02.2015, vendosi shpërndarjen e 100% të shumës së akorduar nga buxheti i shtetit partive politike për vitin 2015, si më poshtë:

NR.	EMËRTIMI I PARTISË POLITIKE	FONDI QË PËRFITOHET (LEKE)
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	73.676.617
2.	Partia Demokratike	57.179.867
3.	Levizja Socialiste për Integrim	20.575.897
4.	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	7.518.047
5.	Partia Republikane Shqiptare	6.632.077
6.	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	4.130.537
7.	Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë	4.130.537
8.	Fryma e Re Demokratike	3.489.667
9.	Partia Demokracia Sociale	3.166.667
10.	Partia Socialdemokrate	3.166.667
11.	Partia Demokristiane e Shqipërisë	3.166.667
12.	Aleanca Kuq e Zi	3.166.667
	Totali	190.000.000

Çelja e fondeve partive politike, në zbatim të ligjit "Për partitë politike", u bë pas dorëzimit të raporteve financiare vjetore nga ana e partive politike.

I.6 PLANIFIKIMI

1.6 1 Logjistika zgjedhore

Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore është një elementet shumë i rëndësishëm në përgatitjen dhe organizimin e zgjedhjeve, në funksion të disponimit të plotë të bazës materiale logjistike dhe dokumentacionit zgjedhor që përdoret në çdo zonë të administrimit të zgjedhjeve, në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave (VNV).

Në pjesën më të madhe të tyre të gjitha produktet që përdoren për logjistikën zgjedhore janë të personalizuar (përdoren vetëm për zgjedhjet e radhës). Si të tilla ato kërkojnë kohën e tyre për tu përgatitur/prodhuar. Një koordinim i mirë i punës ndërmjet përgatitjes së akteve/vendimeve për miratimin e specifikimeve nga KQZ-ja, kryerjes së procedurave prokuruese, lidhjes së kontratave dhe lëvritimit të mallit, bëri që këto mallra të jenë gati për tu përpunuar nga Drejtoria e Logjistikës në afate optimale kohore.

Ishte pikërisht ky fakt që bëri të mundur përgatitjen dhe shpërndarjen në kohë dhe me cilësi madje para afatit të parashikuar në Kodin Zgjedhor të të gjithë bazës logjistike zgjedhore, *përfshirë këtu edhe fletët e votimit*, në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor, duke garantuar një standard të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të logjistikës zgjedhore.

Sa më sipër, çdo Komision Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komision i Qendrës së Votimit (KQV) ka patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të domosdoshme për zbatimin e procedurave dhe përmbushjes së detyrave që i ngarkohen këtyre komisioneve për ditën e votimit dhe më pas të numërimit të votave deri në nxjerrje të rezultatit të votimeve për çdo zonë zgjedhore.

Ajo që vlen të thekohet, është fakti se procesi i hapjes së qendrave të votimit dhe fillimi i procesit të votimit nuk u vërejt dhe nuk u shoqërua me asnjë vendimmarrje të KQZ për mungesë të materialeve zgjedhore, si rrallë ndonjëherë në të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara deri më sot.

Risi e këtyre zgjedhjeve ishte përgatitja e maskave (shabloneve) të fletëve të votimit për secilin format (kandidat/këshill), për t'u mundur votuesve të verbër të shprehnin vetë vullnetin e tyre. Kjo ndodhi për herë të parë në të gjithë historikun e zgjedhjeve vendore të zhvilluara në Shqipëri. KQZ-ja në bashkëpunim edhe me grupet e interesit të këtyre personave krijoi një data base, me të dhënat për personat e verbër duke identifikuar qendrat e votimit se ku votonin këta zgjedhës. Në bazë të këtij database, u bë e mundur që për çdo qendër votimi ku kishte qoftë edhe një votues të kësaj kategorie, të pajisej me maskat (shabllonet) përkatëse.

Duke pasur parasysh llojin e këtyre zgjedhjeve, ku përdoren dy fletë votimi, si dhe përmasat e fletës së votimit për këshill, përgatitja e tyre ishte mjaft e vështirë, kjo për shkak edhe të natyrës së shkrimit Brail.

Si pjesë e bazës logjistike zgjedhore, ashtu siç ka vepruar në të gjithë zgjedhjet pararendëse, KQZ-ja përgatiti edhe dhomat e fshehtësisë për personat me aftësi të kufizuar, për rreth 2000 qendra votimi, sipas të dhënave të administruara në databaze e hartuar. Kërkesat më të mëdha të kësaj kategorie, kryesisht e votuesve tetraplegjikë, ka qenë krijimi i kushteve për hyrjen në godina ku ndodhen qendrat e votimit (ndërtimi i rampave). Edhe pse kjo nuk është në kompetencë dhe tejkalon mundësitë financiare të KQZ-së, i është kushtuar vëmendje maksimale duke i kërkuar pushtetit lokal krijimin e të gjitha kushteve për të bërë të arritshme QV-të edhe nga kjo kategori votuesish.

Pavarësisht infrastrukturës dhe procedurave të ndjekura me korrektësi në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe Akteve të KQZ-së, problemi i përhershëm i KQZ-së ka qenë përballja me pretendimin e palëve/subjekteve zgjedhore për garantimin e paprekshmërisë së kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore në ambientet e brendshme të magazinave të KQZ-së.

Për të eliminuar këtë fakt, KQZ-ja bëri të mundur monitorimin on-line nëpërmjet aksesit të personalizuar të të gjithë subjekteve të interesuara (parti politike) gjatë 24 orëve të të gjithë veprimtarisë që zhvillohej në magazinat e Llundrës para dhe pas ditës së votimit.

Ndërkohë, për sa i përket sigurisë që ofrojnë këto ambiente, gjatë gjithë periudhës zgjedhore, është për të theksuar se të dy magazinat kanë qenë dhe janë në ruajtje nga kompani sigurimi private dhe në ambientet e brendshme janë të aktivizuara kamerat e sigurisë.

Një vëmendje të shtuar gjatë përgatitjes së këtij procesi zgjedhor, KQZ-ja i kushtoi krijimit të mundësive për personat me aftësi të kufizuar për të shprehur lirisht vullnetin e tyre gjatë votimit.

Së fundmi rezulton se materialet zgjedhore, duke filluar nga ato elementare si zarfat e ndryshme dhe deri te fletët dhe kutitë e votimit, nga zgjedhjet e zhvilluara deri këto të fundit janë përmirësuar dhe, pa frikë mund të themi se janë të një shkalle të lartë sigurie.

E rëndësishme është se në këto zgjedhje nuk kemi patur mungesa dhe ankesa, gjithsesi është e rëndësishme që në zgjedhjet e ardhshme të rritet me shumë siguria e transportit dhe korrektesa në dorëzimin e bazës materiale zgjedhore dhe njëkohësisht të kemi më shumë kujdes për gabimet teknike në fletët e votimit.

1.6.2 Burimet Njerëzore në KQZ - rekrutimi i stafit

Burimet njerëzore në KQZ, ku përfshihen jo vetëm administrata e përhershme, por dhe ajo e përkohshme e rekrutuar në prag zgjedhje në përputhje me aktet ligjore të nxjerra në këtë drejtim, janë pjesë shumë e rëndësishme që ecuria e një procesi zgjedhor të jetë i suksesshëm.

Në strukturën e KQZ-së, pozicione pune që trajtohen me statusin e nëpunësit civil janë 30 (tridhjetë) nëpunës. Nga këto, janë konfirmuar me akt-deklarimi 26 (njëzetegjashtë) nëpunës civil, 2 (dy) janë në periudhë prove, 1 (një) vend është vakant dhe 1 (një) pozicion pune proceduar me masë disiplinore. Janë edhe 16 punonjës që trajtohen me kontrata pune dhe të nënshkruara sipas Kodit të Punës.

Nr.	Emërtesa	Numri i punonjësve	Ndarja sipas Gjinisë	
			Femra	Meshkuj
1	Trupa e KQZ-së	7	3	4
2	Nëpunës civil	30	17	13
3	Punonjës me Kod Pune	18	9	9
	Totali	55	29	26

Në zbatim të legjisllacionit për nëpunësit civil, fundi i vitit 2014, përkoi me përcaktimin e objektivave të institucionit, të drejtorive dhe të çdo nëpunësi. Objektivi kryesor për të gjithë strukturat ishte realizimi dhe përmbushja me sukses e planit orientues të veprimeve të KQZ,

miratuar me vendim 161, datë 24.12.2014, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore për vitin 2015.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të performancës së burimeve njerëzore, të institucionit, ato janë përfshirë në programe trajnimi cilësore, profesionale dhe periodike, të organizuara jo vetëm nga Shkolla Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), në përputhje me nevojat reale të tyre, por dhe zhvillimin e disa programeve të trajnimeve brenda institucionit të KQZ-së.

Gjithashtu, janë zhvilluar trajnime të nëpunësve edhe me organizatat ndërkombëtare ku shkëmbimi i eksperiencës apo vizitave studimore në vende të ndryshme kanë sjellë rritje të performancës, kualifikimit dhe ngritjes së nivelit profesional të administratës së KQZ-së, për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Vlen të theksohet se rekrutimi i personelit të përkohshëm është bërë duke përmirësuar standardet me qëllim prurjen e individëve të duhur, në kohën dhe vendin e duhur, në përmbushje të nevojave të çdo drejtorie. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u hartuan dhe u nënshkruan kontratat e punës tip, për personelin mbështetës që gjithsej kanë qenë 313, për çdo pozicion pune. U hartuan dhe u nënshkruan 24 kontrata pune me inspektorët rajonalë, 52 kontrata pune me trajnuesit e KZAZ-ve, 280 kontrata pune trajnues të KQV-ve dhe 90 kontrata pune me trajnues të GNV.

Sidoqoftë nisur nga eksperiencat në vite, si dhe rekrutimi i një stafi në pjesën më të madhe i përshtatshëm për detyrat e ngarkuara, bëri që drejtoritë të realizojnë të gjithë detyrat e ngarkuara në kohë dhe me këto cilësi dhe në sajë të operativitetit të tyre, bënë të mundur "korigjimin" apo përbalimin e çdo shtate të paparashikuar gjatë shpërndarjes së bazës materiale zgjedhore për të mos cënuar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 21, pika 21 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka kompetencën ligjore për miratimin e strukturë-organikës dhe strukturës së pagave të punonjësve të administratës së saj.

Referuar Rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, për zgjedhjet për Kuvendin 2013 dhe për zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të vitit 2015, ku kanë përcaktuar "Rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të Administratës së KQZ-së", duke synuar përmirësimin dhe performancën e burimeve njerëzore, ndryshimet në strukturë-organikën dhe strukturën e pagave të administratës së KQZ-së, janë të domosdoshme. Njëherazi këto ndryshime mbështeten në VKM nr.893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe procedurat e hollësishme për përgatitjen, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm".

Duke qenë se, ndryshimi i strukturë-organikës shoqërohet me kosto financiare dhe sjellin impakt në buxhetin vjetor përkatës, drafti me propozime ku parashikoheshin disa strukturime në drejtori të ndryshme të institucionit dhe ndryshime të pagave për disa pozicione pune, u paraqit në komisionin e ligjeve duke argumentuar ndryshimet përkatëse. Ky draft i paraqitur nuk gjeti dakortësinë në komisionin e ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, për t'u bërë efektiv.

Në këto rrethana, nevojë imediate ngelet riorganizimi i strukturë-organikës së KQZ-së, në të cilën duhet të reflektohen të gjitha ndryshimet përkatëse në fushën e legjislacionit të Statusit të Nëpunësit Civil, në bazë të të cilit funksionon administrata e KQZ-së.

1.6.3 Prokurimet

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në funksion të realizimit që ka për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, ka detyrimin ligjor për sigurimin e të gjithë bazës logjistike zgjedhore (mallra dhe shërbime). Ky detyrim përmbushet nëpërmjet realizimit të procedurave prokuruese lidhur me disponimin e bazës materiale zgjedhore.

Në këtë kontekst njësia e prokurimit, organizoi zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit, të cilat finalizohen me nënshkrimin e kontratave me operatorët ekonomik të shpallur fitues, për të bërë të mundur pajisjen në kohë me bazën logjistike zgjedhore të domosdoshme për zhvillimin e zgjedhjeve.

Vlen të theksohet fakti, se KQZ-ja në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, i realizoi thuajse të gjithë procedurat prokuruese në formën e "procedurës së hapur" apo "kërkesë për propozime", me njoftimin publik në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, ç'ka dëshmon një rritje të transparencës dhe konkurrencës gjatë zhvillimit të këtyre procedurave.

Edhe pse në një periudhë kohore mjaft të ngjeshur, u realizuan të gjitha procedurat prokuruese dhe u sigurua e gjithë baza logjistike zgjedhore në kohë dhe me cilësi, ç'ka ndihmoi drejtpërdrejtë në organizimin e punës së drejtorive përkatëse në përgjithësi dhe Drejtorisë së Shërbimeve dhe Logjistikës Zgjedhore për përpunimin, në veçanti, përgatitjen dhe shpërndarjen e kësaj baze në komisionet e nivelit të dytë dhe të tretë.

Në përfundim, si rezultat i planifikimit dhe zhvillimit korrekt të këtyre procedurave, baza materiale logjistike rezultoi efikase dhe ndihmoi drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve.

I.7 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

1.7.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore

Për një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis KQZ dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të qeverisjes vendore, në funksion të organizimit, miradministrimit të procesit zgjedhor dhe rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së, u ngritën dhe funksionuan 24 Zyra Rajonale Zgjedhore (ZRZ). 12 ZRZ në qytetet qendër qarku dhe 12 ZRZ në njësi të tjera administrative me vendndodhje të largët me qendrën e qarkut, për herë të parë duke përcaktuar njësitë administrative si kompetencën/përgjegjësitë territoriale të çdo ZRZ².

24 Inspektorët rajonalë të emëruar nga KQZ, u trajnuan për të përmbushur detyrën e tyre në këtë proces zgjedhor.

Sigurimi i ambienteve dhe pajisjeve të punës për ZRZ, nga ana e Institucionit të Prefektit, apo Bashkive, u realizua me vështirësi, ç'ka çënoi funksionalitetin e punës së ZRZ-ve, si dhe angazhoi KQZ në përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e situatës.

Zyrat Rajonale Zgjedhore kanë dhënë asistencë në punën e KZAZ-ve, KQV-ve, për kryerjen e njoftimeve të ndryshme dhe shpërndarjen e dokumentacionit (vendime, instruksione), në procesin e shpërndarjes së bazës materiale, për kryerjen e verifikimeve dhe gjatë procesit të numërimit. Kanë raportuar menjëherë për problematikat, si dhe kanë shpërndarë apo përcjellë në KQZ çdo material apo informacion që kërkohej. Ndihmë e madhe është kryerja nga IR e

² Zyrat Rajonale Zgjedhore u ngritën në Bashkitë Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Krujë, Elbasan, Librazhd, Fier, Lushnjë, Gjirokastër, Përmet, Korçë, Pogradec, Kukës, Bajram Curri, Lezhë, Rëshen, Shkodër, Pukë, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Sarandë.

verifikimeve të ndryshme në terren, pasi për shkak të dinamikave të procesit, afateve kohore të limituara, distancave gjeografike, administrata e KQZ e ka të pamundur kryejen e të gjithë verifikimeve të nevojshme/ kërkua.

Risi e këtij procesi ishte angazhimi si Nd/inspektor rajonal i 12 personave me aftësi të caktuara, detyra kryesore e të cilëve ishte raportimi në KQZ për përshtatshmërinë e qendrave të votimit ku ishin të regjistruar zgjedhës PAK. Nga raportimet, problematikë kryesore është mungesa e rampave në 90% të QV-ve të inspektuara prej tyre.

1.7.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

Menjëherë pas hyrjes në fuqi më datë 06.04.2015, të ligjit 31/2015, datë 02.04.2015, që ndryshoi Kodin Zgjedhor, KQZ më datë 7.04.2015, me aktet përkatëse:

- shpalli, sipas rezultatit të shortit, partitë politike që do të propozonin anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, sipas ndarjes tek/çift;
- përcaktoi njësitë administrative ku do të ngriheshin zyrat e 90 KZAZ-ve;
- vendosi që mbledhja e parë e KZAZ-ve të thirret në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 14 prill 2015, në ora 10:00.

Afatet kohore tejet të ngushtuara, sollën për KQZ-në sfida, përballimi i të cilave vinte në provë si kurrë më parë aftësitë operacionale dhe organizative, dhe që u përballën me sukses. Konkretisht, në vetëm 7 ditë, u arrit që KZAZ-të në të gjithë vendin të ngriheshin dhe të ishin në detyrë për realizimin e detyrave:

- Brenda dy ditëve (15 ditë afati sipas Kodit Zgjedhor) u krye verifikimi i plotësimin të kriterëve ligjore të 720 kandidaturave të propozuara për anëtarë të KZAZ-ve (arsimi, gjendja gjyqësore, vendbanimi, masa disiplinore në proceset pararendëse, raporti gjinor). Partitë politike nuk respektuan në të gjitha rastet afatin dy ditor për të dorëzuar propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, duke e vështirësuar më tej punën. Pavarësisht se vetëm çështja e anëtarit të 7-të të KZAZ-ve u qartësua më datë 7.04.2015, për pjesën tjetër të anëtarësisë, akti përkatës ishte miratuar me kohë, dhe tabloja "kush do të propozojë kë" ishte e qartë. KQZ miratoi më datë 13.04.2015 aktin për emërimin e të gjithë anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, dhe vendimi u publikua menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së;
- Brenda 7 ditëve, u siguruan ambientet për zyrat e KZAZ-ve. U ndërtua menjëherë databaze me adresat e zyrave të KZAZ-ve dhe menjëherë u publikua në faqen zyrtare të KQZ-së;
- Brenda një dite (datë 14.04.2015) u realizua konstituimi i të 90 KZAZ-ve, falë një plani të mirëstudiuar në bashkëpunim me Postën Shqiptare. Po këtë ditë u administruan në KQZ të gjithë propozimet për Kryetarë dhe Nënkryetarë të KZAZ-ve;
- KQZ emëroi të 90 Kryetarët dhe 90 Nënkryetarët e KZAZ-ve me datë 15.04.2015, mbi bazën e propozimeve përkatëse të KZAZ-ve respektive. Vendimet u përcollën pranë KZAZ-ve, dhe inspektorëve rajonalë nëpërmjet postës elektronike.

Konstituimi i KZAZ-ve ishte një nga momentet më të ngarkuara, pasi megjithë kërkesën e bërë, partitë politike nuk vunë në dispozicion numra kontakti telefonik të të propozuarve, dhe ishte shumë e vështirë të komunikohesh me njerëz, që në jo pak raste as nuk kishin marrë njoftim nga partitë se ishin propozuar/emëruar si komisionerë, apo u njoftuan në momentin e fundit. Pati raste, kur KZAZ-ve iu vunë në dispozicion ambiente krejt të papërshtatshme, dhe për këtë shkak komisionerët nuk pranonin të kryenin mbledhjen e parë duke i dhënë problemit edhe jehonë mediatike (rasti i Shkodrës). Funksionaliteti i punës së KZAZ-ve u cënua nga mungesa të pajisjeve logjistike: kompjutera dhe printera, apo mungesës së lidhjes me internet. Falë bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, u mundësua pajisja me kompjuter e të gjitha KZAZ-ve me zyra në shkolla, dhe me ndihmën e OSBE u bë e mundur pajisja e 40 KZAZ-ve me kompjuter, dhe në disa KZAZ u shpërndanë dhe printera, por pati KZAZ që nuk e kishin një të tillë, deri 10 ditë para datës së zgjedhjeve. Rreth datës 9 qershor

2015, të gjitha KZAZ-të u plotësuan 100 % me printera dhe fotokopje.


Që në momentin e konstituimit KZAZ-të u pajisën me bazën e nevojshme ligjore, dokumentare dhe kancelarike.

Procedurat e regjistrimit të kandidatëve dhe listave shumëmbrore, nga KZAZ-të që ligji i përcaktonte këtë kompetencë, u krye përgjithësisht me korrektesë, por u evidentuan dhe probleme që e cënuan atë, si:

- Mosrespektimi rigoroz i orarit në ditët e kryerjes së procedurave të regjistrimit;
- Moszbatimi rigoroz i ligjit, duke mos pranuar dokumentet e kandidimit, duke u përpjekur të argumentojnë paligjshmërinë me "moskuptim" të mirë të ligjit;
- Pretendime abuzive dhe të pavërteta të subjekteve zgjedhore, të cilat mosparaqitjen e dokumenteve për probleme të tyre, përpiqeshin t'ia atribuonin KZAZ-ve.

Për qartësimin e këtyre procedurave, u përgatit dhe iu shpërnda të gjithë KZAZ-ve nëpërmjet postës elektronike, po ashtu dhe inspektorëve rajonalë, një material i vecantë, ku afatet përcaktoheshin me data konkrete, qartësohej dokumentacioni i kandidimit, si dhe forma e duhur për paraqitjen e tij.

Pas emërimeve fillestare të anëtarëve të KZAZ-ve, partitë politike ligjërisht kërkuan lirim/emërim të komisionerëve/sekretarëve të KZAZ-ve. KQZ disponoi me 48 vendime zëvendësimet e kërkuara nga partitë politike për 271 komisionerë, ose 37.6%. Në analizë të krahasuar me vitin 2013, kur janë zëvendësuar 253 komisionerë, pra 35.5% e numrit të përgjithshëm, dëshmohet qartë trendi në rritje të diskrecionit të partive politike për të liruar/zëvendësuar burimet njerëzore të këtyre strukturave, veçanërisht gjatë muajit të zgjedhjeve.



Partitë politike që Kodi Zgjedhor i detyron për respektimin e kuotës gjinore 30% në propozimet për anëtarësinë e KZAZ-ve, e respektuan dhe madje e tejkaluan këtë përqindje në propozimet e para, dhe gjithashtu respektuan kriterin gjinor në të gjitha propozimet për lirim-emërim në vijim. PS nga 270 komisionerë të propozuar 97 i përkisnin gjinisë femërore, PD nga 270 komisionerë të propozuar 90 i përkisnin gjinisë femërore, PR nga 90 komisionerë të propozuar 10 i përkisnin gjinisë

femërore, LSI nga 90 komisionerë të propozuar 10 i përkisnin gjinisë femërore. Në zgjedhjet e vitit 2013, nga 712 komisionerë të KZAZ-ve, 175 ishin femra, dhe në 2015, nga 720 komisionerë të KZAZ-ve, 207 ishin femra, shifra që dëshmojnë për rritje të përfaqësimit gjinor në anëtarësinë e KZAZ.


KQZ, liroi nga detyra kryesisht dy anëtarë të KZAZ-ve, për shkak të lidhjeve fisnore me kandidatët, shkarkoi gjashtë anëtarë të KZAZ nr.15, Qarku Lezhë për shkak të mospërbushjes së detyrimeve ligjore. Për plotësimin e kuorumit të KZAZ nr.15, qarku Lezhë, i cili do të siguronte zhvillimin e procesit në këtë ZAZ, ku situata vijonte të ishte e bllokuar deri në orët e vona të datës 20 qershor, duke vënë në rrezik hapjen e qendrave të votimit, KQZ emëroi kryesisht një anëtar të KZAZ-së nr.15, qarku Lezhë, të përzgjedhur nga kandidaturat që kishin shprehur interes, dhe dokumentacionin përkatës, për tu angazhuar si komisioner zgjedhor³.

Gjatë inspektimeve të kryera, është konstatuar se thuajse të gjitha KZAZ-të kishin vendosur tabelat treguese pranë objekteve ku kishin selitë me numrat e telefonit dhe emrat e kryetarit,

³ Udhëzimi i KQZ-së nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV"


Zv/Kryetarit dhe Sekretarit të KZAZ-së. Me afrimin e datës së zgjedhjeve dhe me intensifikimin e punës së KZAZ-ve, kjo problematikë nuk u has më dhe thuajse në të gjitha rastet në zyrat e KZAZ-ve kishte prezencë të komisionerëve të përkatësive të pozitës dhe opozitës parlamentare.

1.7.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve



KQZ, e monitoroi në dinamikë dhe me efikasitet procesin e ngritjes së KQV-ve, pasi kuadri nënligjor i ri detyronte KZAZ që menjëherë pas emërimit të anëtarëve të KQV, të dërgonin kopje të vendimeve. Partitë politike në shumicën e rasteve nuk kanë paraqitur në afat propozimet për anëtarët e KQV-ve (30 ditë para datës së zgjedhjeve). Të gjitha KZAZ-të, i kanë dërguar degëve të partive politike në rrethet përkatëse kërkesë për dërgimin e propozimeve të anëtarëve të KQV-ve brenda afatit ligjor dhe një gjë e tillë është bërë edhe nga KQZ përmes deklarimeve në mbledhje apo deklaratave për shtyp. Rastet më tipike ishin KZAZ-të e Bashkisë Shkodër, Bashkisë Elbasan,

ku propozimet u paraqitën përpara se të shpërndahej baza materiale. Kjo sjellje "neglizhence" erdhi si pasojë :



- Kompromiseve të anëtarëve të KZAZ-ve në favor të interesave partiake;
- Mosbesimit të subjekteve në kandidatura për komisionerë QV;
- Ruajtjes së konfidencialitetit të propozimeve (mos ta dijë subjekti kundërshtar);

Hapja e qendrave të votimit, ecuria dhe mbyllja e votimit, dorëzimi i materialeve zgjedhore, janë kryer në kohë dhe pa

problematika. Mungesa totale e adresimeve/ankimeve shpresore nga ana e partive politike apo KZAZ-ve gjatë ditës së votimit është tregues domethënës për qetësinë e ditës së votimit, krahasuar me 27 ankesa të protokolluara gjatë ditës së zgjedhjeve të 2011.

Vetëm një QV në shkallë vendi nuk u hap (QV e posaçme e caktuar në burgun e Rrogozhinës), për shkak se KZAZ-ja nuk mori vendim për ngritjen dhe funksionimin e kësaj QV, megjithë urdhërimin nga KQZ. Ky fakt bëri që zgjedhjet në këtë QV të shpalleshin të pavlefshme⁴.

U përdorën 4 vula rezervë për qendrat e votimit në ambiente të posaçme, ku votimi filloi me vonesë për shkak se KZAZ-të përkatëse ekzekutuan me vonesë vendimin e KQZ-së nr. 723 "Për sigurimin e fletëve të votimit shtesë për disa qendra votimi të posaçme".⁵

Në dy QV u përdorën vula rezerve për shkak të deklarimit të humbjes së tyre. Asnjë komisioner nuk braktisi detyrën.

Zbatimi korrekt i procedurave të mbylljes së votimit, dëshmohet edhe nga fakti se vetëm 4 kuti në të gjithë territorin e Shqipërisë u konsideruan si të parregullta nga ana e grupeve të marrjes në dorëzim, ç'ka përbën një ndryshim të ndjeshëm nga gjithë zgjedhjet e tjera.

Përfaqësimi gjinor në KQV, dëshmojnë për një realitet shumë larg të kërkuarit nga Ligji "Për

⁴ KZAZ Nr. 43, QV nr. 22242

⁵ KZAZ nr. 20, QV nr. 12921 dhe QV nr. 1274, KZAZ nr. 22, QV nr. 14222, KZAZ nr. 44, QV nr. 22732

barazinë gjinore në shoqëri". Pothuaj gjysma e KQV-ve janë pa përfaqësim gjinor në përbërjen e tyre. Për ndryshimin e këtij realiteti, Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë kuotë gjinore edhe për propozimet për anëtarë të KQV.


1.7.4 Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve

Caktimi i Vendeve të Numërimit të Votave, dhe përshtatja e tyre, është një tjetër etapë shumë e rëndësishme e përgatitjes së infrastrukturës zgjedhore, e cila kryhet në bashkëpunim me institucionet e Prefektit. Për shkak të territoreve të zonave të reja të administrimit zgjedhor, 21 ambiente propozoheshin për herë të parë për t'u caktuar si VNV. KQZ, miratoi në afat 90 VNV mbi bazën e propozimeve të Prefektëve, por në 9 raste u detyrua të ricaktonte me vendim Vendin e Numërimit të Votave, për shkak të propozimeve të dyta të Prefektëve, të korrigjonin të parat, apo për shkak se propozimi i parë kishte referuar të dhëna të pasakta. Të gjitha ambientet e propozuara nga Prefektët janë inspektuar për përshtatshmërinë e tyre. VNV kanë qënë të përshtatshme dhe të konfiguruar në përputhje me ligjin. KZAZ-të kanë organizuar më së miri VNV-në, duke respektuar me rigorozitet përcaktimet e Udhëzimit të KQZ "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të VNV".

	Emerimet e anetareve te GNV	Ne perqindje
Kane derguar ne KQZ vendimet e emerimit te GNV	21 KZAZ	23.00%
Kane emeruar jashte afatit anetaret e GNV	69 KZAZ	77%


Në rang kombëtar funksionuan 860 grupe numërimi, propozimet në të gjitha rastet janë paraqitur në tejkalim të afateve ligjore, në limitet e fundit. Përpara fillimit të procesit të numërimit të votave u organizuan sesione të shkurtra trajnimi me anëtarët e grupeve të numërimit, nga ana e trajnerëve të caktuar nga KQZ.

Përfaqësimi gjinor në GNV, gjithashtu dëshmon nevojën që Kodi Zgjedhor të përcaktojë kuotat gjinore edhe për përbërjen e GNV-ve.



GNV-të kryen përgjithësisht me korrektësi procedurat e numërimit të votave, përfshirë edhe administrimin e votës në kutinë e gabuar. Zgjatja e numërimit të votave tej afateve ligjore, erdhi si pasojë e faktorëve: pushimet për shkak të lodhjes, numri i madh i QV-ve për KZAZ të caktuara, ndërhyrjet e personave të pranishëm në VNV, të cilat në jo pak raste ishin joligjore.

TRAJNUES KZAZ, KQV DHE GNV - VITI 2015



1.8 TRAJNIMET

1.8.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve

"Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015", miratuar nga KQZ me vendimin nr. 12, datë 21.01.2015, në vlerësim të

rëndësisë që ka profesionalizmi i administratës zgjedhore për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, përcaktoi llojet e trajnimeve, kalendarin e zhvillimit të tyre, materialet që do të përdreshin, numrin e trajnerëve që do të angazhoheshin, si dhe kriteret përzgjedhëse për ta. Numri i trajnerëve u përcaktua në varësi të numrit të komisionerëve të nivelit të dytë dhe të tretë, dhe grupeve të numërimit të votave:

52 trajnerë për trajnimin e 720 komisionerëve të nivelit të dytë (anëtarë dhe sekretarë të 90 KZAZ-ve);

280 trajnerë për trajnimin e 37.107 anëtarëve dhe sekretarëve të 5301 KQV-ve;

90 trajnerë për trajnimin e 3484 numëruesve të 866 Grupeve të Numërimit të Votave.

Në total u përzgjedhën dhe angazhuan 280 trajnerë⁶.

Procedura e përzgjedhjes së trajnuesve ishte transparente, bazuar në proces të hapur konkurimi. Kriteret dhe procedurat përzgjedhëse u shpallën në faqen zyrtare të institucionit. Përzgjedhja u krye bazuar jo vetëm në dokumentacionin e paraqitur, por edhe në intervistë verbale, ku kandidati testohej edhe për aftësitë e komunikimit publik. U paraqitën mbi 350 kërkesa të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Në përfundim të procedurave, kryesisht u përzgjedhën juristë, me eksperiencë të mëparshme zgjedhore, fakt i cili i shërben konsolidimit të trupës së trajnuesve me eksperiencë që KQZ angazhon për trajnimin e administratës zgjedhore.

Trajnimi i trajnerëve u krye nga administrata e KQZ-së, në Tiranë. Prezenca e OSBE-së dhe Zyra e KE-së, kontribuan për realizimin e tij sa i përket aspekteve logjistike (salla trajnimi etj). Konkretisht :

- Trajnerët e KZAZ-ve (52) u trajnuan në dy grupe, së bashku me inspektorët rajonalë (24 IZRZ), në dy programe trajnimi me kohëzgjatje 1 (një) ditore. Kjo ndarje i shërbeu rritjes së efikasitetit të trajnimit, duke e lidhur atë ngushtësisht me procedurat e fazave konkrete të procesit zgjedhor⁷.
- Trajnerët e KQV-ve (280) u trajnuan gjatë 4 ditëve, të ndarë në 8 grupe⁸.
- Trajnerët e GNV-ve, u trajnuan më datë 16 qershor 2015 (dy grupe).

Trajnerët u trajnuan dhe instruktuan për t'i zhvilluar sesionet e trajnimit në formë interaktive, me demonstrime praktike. "Guida e trajnerëve", një material udhëzues, i shërbeu rritjes së aftësive të prezantimit të trajnerëve, si dhe mirëstrukturimit të sesioneve të trajnimit.

1.8.2 **Zhvillimi i trajnimit**

Kurrikulat dhe metodologjia që KQZ miratoi dhe realizoi për të gjitha programet e trajnimit për zgjedhjet vendore 2015, u përgatitën mbështetur në eksperiencën e fituar në vite, me synimin për t'i transmetuar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme konceptet ligjore, shoqëruar me ilustrime praktike. Për KZAZ-të u përgatitën dy manuale trajnuese me fletore pune përkatëse. Për shkak të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në prill 2015, instruksionet dhe udhëzimet për procedura të rëndësishme, si regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i kandidimit, etj, u trajtuan si aneks i Manualit të KZAZ-së. Për KQV-të dhe GNV-të, instruksione të hollësishme për mënyrën e kryerjes së procedurave, u dhanë në Manualin e KQV-së dhe Manualin e GNV-së. Manualët e trajnimit, pavarësisht se botohen për çdo proces zgjedhor, në këto zgjedhje reflektuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor, kuadrin

⁶ Bazuar në eksperiencat e administruara, trajnerët e KZAZ-ve, angazhohen dhe për trajnimin e KQV-ve dhe GNV-ve.

⁷ Programi i parë u zhvillua më 11 prill 2015, dhe programi i dytë u zhvillua më 31 maj 2015.

⁸ 7-10 qershor 2015

nënligjor të miratuar nga KQZ për këtë proces, veçanërisht qartësimin e procedurave të reja ligjore për mënyrën e administrimit të votës në kutinë e gabuar, dispozitat e Kodit Penal për vepra penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Fletoret e punës, si pjesë integrale e çdo manuali, përmbanin modelet e vendimeve që komisionerët do të përdornin në punën e tyre, po ashtu dhe shembuj praktikë se si veprohej në situata të caktuara.

Për çdo komisioner apo numërues, u shpërnda manuali i trajnimit dhe fletorja e punës, CD me aktet nënligjore të KQZ-së, një set i plotë materialesh trajnuese, i cili do t'i shërbente çdo komisioneri zgjedhor edhe gjatë ushtrimit të detyrës, si referencë për përmbushjen e rregullt të saj.

Për të gjitha programet e trajnimit, u përgatitën dhe u shpërndanë gjithashtu prezantime me poëerpoint, video trajnimi dhe fleep-chart. Në vlerësim të specifikave të procedurave të regjistrimit të kandidatëve për kryetarë bashkie/listave për këshillat bashkiakë, vështirësive që mund të përballnin 51 KZAZ-të që ligji i ngarkonte me kryerjen e kësaj veprimtarie, u përgatit dhe u shpërnda për to elektronikisht material i veçantë, ku afatet ligjore përktheheshin në data konkrete, dhe jepeshin instruksione dhe detajime për regjistrimin e dokumentacionit të kandidimit.

Manualet e trajnimit ishin gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të KQZ-së, si një mundësi alternative për përdorim nga komisionerët zgjedhorë të çdo niveli. Programet aplikative për mësim on-line për funksione të ndryshme të administrimit zgjedhor (KZAZ, KQV, GNV), të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, ishin një mundësi tjetër për t'i ardhur në ndihmë komisionerëve zgjedhorë për rritjen e profesionalizmit të tyre.

Video e trajnimit për anëtarët e KQV-së, e cila u realizua për herë të parë për zgjedhjet 2015, me mbështetjen e UNDP-së, ishte një material trajnues shumë i qartë dhe praktik. Etapat e veprimtarisë së KQV, trajtoheshin si leksione të veçanta, dhe përmbylleshin me pyetje-përgjigje, nëpërmjet të cilave çdo përdorues mund të testonte veten për saktësinë e njohurive. Kjo video u përdor në seancat e trajnimit, dhe vlerësua shumë nga komisionerët. Video për trajnimin e KQV-së, gjithashtu ishte e disponueshme edhe në faqen zyrtare të KQZ-së për çdo të interesuar. Ky publikim synonte t'i vinte në ndihmë çdo komisioneri që për shkaqe objektive apo subjektive nuk kishte marrë pjesë në trajnimin e KQZ-së, apo kishte paqartësi për procedura të caktuara.

- Trajnimi i KZAZ-ve. Programi i parë i trajnimit u zhvillua më datë 15 prill 2015, një ditë pas konstituimit të KZAZ-ve. Trajnimi i dytë për anëtarët dhe sekretarët e 90 KZAZ-ve u zhvillua më datë 2 qershor 2015. Pjesëmarrja e anëtarëve të KZAZ-ve në trajnim:

Pjesëmarrja në		trajnimin e KZAZ-ve në %									
Trajnimi	Total	PS	Femra	PD	Femra	LSI	Femra	PR	Femra	Sekretare	
										PS	PD
1	84	31	41	31	35	11	12	11	2	25	14
2	88	31	38	32	36	14	11	11	11	31	17

Trajnimi i KZAZ-ve, mund të cilësohet si programi më eficient i platformës së trajnimit për zgjedhjet 2015. Kjo për arsye se, ky nivel i administratës zgjedhore funksionon për një periudhë të gjatë kohore, nivelit arsimor dhe përgjegjshmërisë së komisionerëve të emëruar, rregullimit ligjor që moskalimi i testit përbën shkak për shkarkim nga detyra. Rezultatet e testeve të komisionerëve të KZAZ-ve (të zhvilluar pas çdo programi trajnimi), dëshmojnë për nivelin e lartë të njohurive të përfituara.

- Trajnimi i KQV-ve 1 (një) ditë, u realizua në periudhën 12-18 qershor 2015. Për shkaqe si emërimet e vonuara apo zëvendësimeve, trajnimi u zhvillua edhe një ditë para datës së

zgjedhjeve⁹. 50% e komisionerëve morrën pjesë në sesionet e trajnimit, shifër e cila dëshmon se pavarësisht masave të ndërmarra nga KQZ duke e shtrirë trajnimin në të gjithë territorin e vendit dhe ofruar atë për një periudhë të shtrirë në kohë, emërimet e vonuara dhe trajnimet e ofruara nga partitë politike vazhdojnë të mbeten faktorë negativë që çënojnë profesionalizmin e administratës zgjedhore¹⁰.

- Trajnimi i GNV-ve u zhvillua në datat 19-20 qershor 2015. Për shkak të emërimeve të vonuara, anëtarët e grupeve të numërimit u trajnuan edhe përpara se të fillonte procesi i numërimit të votave në VNV.

TRAJNIMI i GNV-ve						
Data e trajnimit	Nr. Pjesëmarrësve	PS	PD	LSI	PR	Të Zëvendësuar pas trajnimit
19	707 (47 KZAZ)	31%	24%	32%	13%	
20	424 (30 KZAZ)	30%	29%	23%	18%	
21	933 (58 KZAZ)	29%	28%	22%	21%	17%
22	810 (32 KZAZ)	27%	25%	26%	22%	22%
23	119	22%	24%	25%	29%	21%
24	31	32%	23%	23%	23%	
Total	3024	29%	26%	25%	20%	20%

Të dhënat e raporteve të trajnerëve në përmbyllje të trajnimit, dëshmojnë për vlerësime të komisionerëve për cilësinë e trajnimit, dhe cilësinë e materialeve të trajnimit.

Sikundër dëshmohet edhe nga shifrat, platforma e trajnimit e zbatuar nga KQZ për zgjedhjet vendore 2015, u cënua nga lirim emërimet e komisionerëve pas trajnimit të tyre, apo nga emërimet e vonuara. Këto fakte dëshmojnë nevojën që trajnimi, si elementi kyç për profesionalizmin e administratës zgjedhore, të kryhet përpara periudhës zgjedhore. Trajnimi i burimeve njerëzore potencialisht komisionerë të nesërm, përpara periudhës zgjedhore, do të përmirësonte ndjeshëm efencën e platformës së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë.

Pas zgjedhjeve 2015, në takime me grupe të fokusuara të komisionerëve zgjedhorë, të asistuar edhe ekspertë ndërkombëtarë, vetë komisionerët kanë pohuar nevojën që trajnimi për administrim zgjedhor të kryhet jashtë periudhës zgjedhore. Sipas pohimeve të tyre, nuk mund të ketë efencë trajnimi i kryer pas emërimit në detyrë, pasi në këtë periudhë ata janë të angazhuar për përbushjen e detyrave me afate kohore të limituara.

Eksperiencia e trajnimeve jashtë zgjedhore që KQZ zhvilloi përgjatë vitit 2014, dëshmoi se partitë politike nuk treguan interes, duke mos orientuar/udhëzuar burime njerëzore për të marrë pjesë në sesionet e trajnimit. Përcaktimi si kusht ligjor se për t'u propozuar si komisioner zgjedhor duhet kryer trajnimi/certifikimi për njohuri zgjedhore, do të sillte një qasje të re të partive politike ndaj trajnimeve në periudhë jashtë zgjedhore.

I.9 INFORMIMI

1.9.1 Edukimi i votuesve

Edukimi zgjedhor i shtetasve, për vetë rëndësinë e tij, nuk është fokusuar vetëm në periudhën e fushatës zgjedhore, por është zhvilluar në vijimësi përmes programeve të zhvilluara në qytetet kryesore të vendit. Këto programe jo vetëm i kanë shërbyer përbushjes së detyrimit ligjor, por kanë krijuar mundësitë për të evidentuar drejtpërdrejti nevojat e zgjedhësve për informacion lidhur me procesin zgjedhor në tërësi si dhe aspekte të



⁹ Gjatë shpërndarjes së bazës material zgjedhore nga KZAZ për KQV-të në juridiksion.

¹⁰ Nga totali i komisionerëve që morrën pjesë në sesionet e trajnimit, 48 % të prozuar nga PS, 31% të propozuar nga PD, 17% të propozuar nga PR dhe 4% të propozuar nga PR.

veçanta të tij, mënyrat dhe mjetet më efikase për të shpërndarë informacionin, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit¹¹. Tema e trajtuar **“Të votosh vlerë e demokracisë - e drejtë dhe detyrë qytetare”**, si dhe simulimi praktik i procedurave të votimit në qendrën e votimit, synonte ndërgjegjësimin, sensibilizimin dhe informimin e të rinjve për vlerën e votës së lirë, si guri i themelit të demokracisë.

Me rëndësi të veçantë ishte celebrimi për herë të parë nga KQZ i Ditës Botërore të Zgjedhjeve, qëllimi i të cilës është përcjellja e mesazheve për rëndësinë e proceseve demokratike, ku padyshim zgjedhjet e lira dhe të drejta janë guri i themelit të zhvillimeve demokratike të vendit. Veprimtaritë të organizuara si “open day” për të gjithë të interesuarit, u ndoqën nga të rinjtë e shkollave të mesme të kryeqytetit, të rinj me aftësi të kufizuara, përfaqësues të organizatave vendase dhe ndërkombëtare që vëzhgojnë zgjedhjet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.11, datë 21.01.2015, miratoi Strategjinë për edukimin zgjedhor të shtetasve, një material bazik, ku përmes programeve të përgjithshme dhe specifike të edukimit zgjedhor, synohej përmbushja e kompetencës për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015.

Objektivat e synuar:

- Rritja e pjesëmarrjes në zgjedhje, nëpërmjet ndërgjegjësimit të votuesve mbi vlerën e votës, shprehje e vullnetit individual;
- Ndërgjegjësimi i votuesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- Edukimi i votuesve për të denoncuar çdo veprim që cënon votën e lirë;
- Mirë informimi i të gjithë zgjedhësve për procedurat ligjore për përmbushjen në mënyrë korrekte të aktit të votimit, orarin e hapjes dhe të mbylljes së qendrave të votimit;
- Rritja e besimit publik tek administrimi i procesit zgjedhor, tek profesionalizmi dhe paaënësia e KQZ-së në organizimin dhe administrimin e gjithë procesit.

Projektet e përgjithshme adresuan të gjithë zgjedhësit shqiptarë, shpërndanë informacion të plotë zgjedhor për çfarë votohet, data, orarin e votimit, procedurat e votimit, të drejtat dhe detyrimet e zgjedhësit, detyrimin qytetar për denoncimin e çdo rasti apo individit që synon të abuzojë me të drejtën e votës, dhe u realizuan përmes:

Spoteve televizive: 3 spote me natyrë informuese, edukuese dhe sensibilizuese, të përshtatura në gjuhën e shenjave, u transmetuan me rotacion të lartë në televizionet kryesore që mbulojnë me sinjal të gjithë territorin e vendit.

Spote radiofonike: 5 spote me natyrë informuese, edukuese dhe sensibilizuese, të cilat u transmetuan me rotacion të lartë në radio kombëtare.

Forma të shkruara: 60 000 fletëpalosje në format xhepi dhe 60 000 fletëpalosje në format A3, me informacion për zgjedhjet, qëllimin e votimit, kush voton, dokumentet e vlefshme të identifikimit për votim, oraret e votimit, fletët e votimit, procedurat e votimit, rregullat që zbatohen në qendrën e votimit, veprimet që duhet të ndërmerren zgjedhësi kur nuk e gjen emrin në listë, kush mund të ndihmojë zgjedhësin që nuk mund të votojë vetë, detyrimet e zgjedhësit që ndihmon një zgjedhës tjetër.

Një numër i konsiderueshëm fletëpalosjesh, u shpërnda në të gjitha pikat e kalimit kufitar, me synim që shtetasit me banim jashtë vendit që do të vinin për të votuar, të kishin informacionin e nevojshëm. Kjo u realizua falë bashkëpunimit të sukseshëm me Policinë e Kufirit.

¹¹ në vijimësi gjatë vitit 2014, në 9 qarqe të vendit: Tiranë, Lezhë, Fier, Durrës, Gjirokastrë, Kukës, Dibër, Vlorë, Berat, j

Postera me informacion zgjedhor, me natyrë edukuese, sensibilizuese për pjesëmarrje në zgjedhje, mënyrën e rregullt të votimit, dhe ndërgjegjsuese për veprimet e ndaluara në zgjedhje, u vendosen në të gjithë ambientet zgjedhore, kryesisht në qendrat e votimit,:

- 40 000 postera nëpërmjet grafikës targetonin të moshuarit;
- 1 000 postera nëpërmjet grafikës targetonin zgjedhësit PAK;
- 2 000 postera nëpërmjet grafikës targetonin të rinjtë;
- 1 000 postera nëpërmjet grafikës targetonin grate;
- 11 000 postera ilustronin procedurat e votimit;
- 11 000 postera informues për veprimet e ndaluara në qendrën e votimit.

Publikime në gazeta: Posterat, u publikuan në 7 gazeta, të përzgjedhura sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ, dhe mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

Pikat e informimit të zgjedhësve, realizuan kontaktin e drejtpërdrejtë me zgjedhësit, si mënyra më e efektshme për shpërndarjen e materialeve edukuese, informuese, sensibilizuese. U ngritën 12 pika të informimit zgjedhor, në 12 qytete kryesore.

Materiale promociionale: bill-board (2 lloje) dhe city-light (30), në qendrat urbane, me mesazhe ndërgjegjësuese/sensibilizuese për pjesëmarrje në votime, me informacion për çfarë votohet, datën e zgjedhjeve, oraret e votimit, dokumentet e vlefshme të identitetit për votim, procedurat e votimit.


Kalendarë tavoline me informacion zgjedhor për etapat/ciklet e procesit zgjedhor (600 copë) bluza (5000), kapele (5000), stilolapsa (160 000) aromatizues makine (5000 copë), mbajtëse çelësash (5000 copë), i shërbyen miqësisë të KQZ-së me zgjedhësit, sensibilizimit dhe informimit të tyre për zgjedhjet e datës

21.06.2015, dhe u shpërndanë për zgjedhësit në qendrat e informimit, si dhe gjatë takimeve të drejtpërdrejta të realizuara.

Edukimi në distancë (online): në faqen zyrtare të KQZ-së, në linkun "Edukimi online", ishte e disponueshme "Hapat që ndjek zgjedhësi gjatë ditës së votimit".

Projektet specifike adresuan:

Zgjedhësit me aftësi të kufizuar. Mesazhi "Të kesh aftësi të kufizuar fizike nuk do të thotë të ndihesh i kufizuar për të ushtruar të drejtën e votës", u përcoll përmes spotit televiziv, të përshtatur në gjuhën e shenjave, i cili qartësonte procedurat e votimit, specifikisht në rastet kur zgjedhësi kërkon ndihmën e një zgjedhësi tjetër.



Gratë. Mesazhi "Të votosh në mënyrë të pandikuar nga vullneti i familjarëve të tu", u përcoll përmes një spoti të veçantë televiziv për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve që vota është shprehje e vullnetit individual, dhe askush nuk ka të drejtë të ndikojë apo cënojë atë.

Pakicat kombëtare. Fletëpalosjet dhe posterat u prodhuan në gjuhë të 5 pakicave kombëtare dhe u shpërndanë në zonat ku komunitetet respektive janë të përqëndruara. Kryetarja e KQZ-së në takime të drejtpërdrejta me zgjedhës të 5 pakicave Kombëtare dha mesazhe ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime.

U zhvilluan takime me gratë të komuniteteve romë në Durrës, Shkodër, Lezhë, Korçë, ku u transmetuan mesazhe ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime, si dhe u qartësuan procedurat e votimit përmes simulimit të një dite votimi në QV.

Të rinjtë, votuesit për herë të parë. Takime/sesione edukimi u realizuan në universitete dhe shkolla të mesme.

RISI & ARRITJE:

- Kontributi qytetar, kontribute vullnetare të të rinjve për realizimin e materialeve edukuese, formë efikase edukimi, qasje e re me procesin dhe administratën zgjedhore;
- Slogani i zgjedhjeve u përzgjedh duke kërkuar dhe vlerësuar mendimin qytetar, nëpërmjet rubrikës së publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së përgjatë vitit 2014, si dhe përthithjes së mendimit nga anketimet e realizuara me grupime të ndryshme;
- Për herë të parë u ngritën dhe funksionuan pikat e informimit zgjedhor në qytete kryesore të vendit, ku çdo shtetas gjente lehtësisht information zgjedhor nëpërmjet fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera edukuese; Pranë këtyre pikave u angazhuan të rinj, në Tiranë të rinj të komunitetit rom;
- U forcua bashkëpunimi me organizatat përfaqësuese të pakicave kombëtare, falë kontributit të të cilave u përkthyen në gjuhët respektive të gjithë materialet edukuese, si dhe u realizua shpërndarja e pjesës më të madhe të tyre;
- Të gjithë materialet edukuese, të projekteve të përgjithshme dhe të veçanta, u prodhuan/shpërndanë/transmetuan në kohë;

1.9.2 Shoqëria

Projekti i sukseshëm, startuar në vitin 2011, u zbatua edhe për zgjedhjet e datës 21.06.2015. Përmes këtij projekti, në të gjitha shkollat e mesme të vendit u realizua fushata e ndërgjegjësimit të votuesve për herë të parë, në një orë mësimi u diskutua rreth së drejtës së votës) si dhe u simulua një dite votimi në qendrën e votimit. Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Politike, mbi bazën e marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit, dhe me mbështetjen financiare të KE-së.

Organizatat e pakicave kombëtare, bashkëpunuan për përshtatjen e materialeve edukuese në gjuhët e tyre dhe për organizimin e takimeve me komunitetet respektive.

Organizatat e personave PAK bashkëpunuan për realizimin e shablloëve (maskave) në alfabetin brail.

Studentët e Universitetit Polis kontribuan vullnetarisht për ideimin dhe realizimin e logos së zgjedhjeve si dhe ideimin dhe realizimin grafik të materialeve edukuese zgjedhore të zgjedhjeve të datës 21.06.2015.

I.10 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

I.10.1 Regjistrimi i partive politike: koalicionet

Një nga detyrat më të rëndësishme që ka KQZ-ja është edhe regjistrimi i subjekteve zgjedhore, si koalicionet, parti politike që garojnë të vetme në zgjedhje dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Si asnjëherë tjetër në zgjedhjet e mëparshme, në zgjedhjet vendore të Qeshorit 2015 ka patur një tendencë për të mos regjistruar kandidatë për kryetar të njësisë vendore dhe kandidatë për këshillat vendore duke shfrytëzuar procedura ligjore dhe ekstra ligjore në kundërshtim me frymën e ligjit zgjedhor.

Për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 u regjistruan si subjekt zgjedhor gjithsej 63 parti politike dhe 26 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit.

Regjistruan lista shumëmemërore gjithsej 61 parti. Nga këto 52 parti janë parti të cilat ishin pjesëtare të Koalicioneve Zgjedhore dhe 9 parti ishin parti të cilat kandiduan më vete.¹²:

Në KQZ u regjistruan si subjekt zgjedhor 2 koalicione zgjedhore


- I. Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
- II. Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane.

Në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2011 numri i partive politike të cilat u regjistruan si subjekt zgjedhor ishte 54, të grupuara në dy koalicione:

- I. Koalicionin Aleanca për Qytetarin i kryesuar nga PD me (22) Parti.
- II. Koalicioni Aleanca për të Ardhmen i kryesuar nga PS me (23) Parti.

Parti Politike që kandiduan me vete ishin (9).

Subjektet Zgjedhore në



U administruan duke i verifikuar për plotësimin e kriterëve ligjore 36.341 kandidatë të 2046 listave shumëmemërore të 61 partive politike, 158 kandidatë për kryetar bashkie të propozuar nga 12 subjekte zgjedhore (koalicione, parti, grup zgjedhësish). Për 10 bashkitë që mbulohen nga më shumë se një ZAZ, e që procesi i regjistrimit të kandidatëve verifikohet e miratohet

¹² Të dhëna të hollësishme jepen në Aneksin 2

nga KQZ, u administruan e kontrolluan 12.549 kandidatë për listat shmemërore ose 34,53 % e gjithë kandidatëve në rang vendi. Mangësitë që u gjetën në këto kandidime (probleme gjinore, banimi, moshe, dublime) iu kthyen propozuesve dhe u korigjuan e mandej u miratuan nga KQZ. Pjesa tjetër e kandidimeve që erdhi në KQZ pas miratimit nga KZAZ-të përkatëse e që përbëjnë 65,47 %, u administrua nga administrata e KQZ-së, u gjetën mangësi por nuk mund të bëheshin rregullime për arsye të kalimit të afateve ligjore. Konkretisht në to pati 123 shkelje të kriterit gjinor nga 39 parti në 28 bashki dhe 67 kandidatë të listave shumemërore të dubluar në 26 bashki. Pothuajse të gjitha rastet me shkelje gjinore nuk arritën të nominohen këshilltarë se partitë që i kanë propozuar nuk fituan mandate në bashkitë që patën bërë shkelje. Vetëm dy raste që përbënin shkelje të kriterit gjinor në listë, një në bashkinë Gjirokastër dhe një në atë Përmet, u zgjodhën këshilltar. Mendojmë se është mundësia për të mos lejuar nga ana e KZAZ-ve të paktën shkeljen e kriterit gjinor, kriter që administrohet brenda listës të një partie politike. Problem disi i vështirë, për kohën relativisht të shkurtër për verifikim, është verifikimi nga ana e KZAZ-ve e dublimeve dhe verifikimi nëse është banor/zgjedhës i bashkisë ku kandidon.

Të dhëna të përmbledhura për kandidimet jepen në tabelën më poshtë:

	subjekte propozuese	kandidatë	femra		të pavarur	
			gjithsej	%	gjithsej	femra
Kandidatë për kryetar	12	158	16	10,13%	14	1
Fituese kryetar	3	61	9	14,75%	0	0
Kandidatë ne listat shumemrore për këshilltarë	61	36.341	17.937	49,36%	12	1
Kandidatë fitues për këshilltarë	58	1.595	555	34,80%	3	0

Në zgjedhjet vendore 2015, problem u krijua dhe me verifikimin e listave mbështetëse të subjekteve zgjedhore që nuk zotëronin mandatet që ligji përcakton. Megjithë kohën e shkurtër, nga momenti që u hoq përdorimi i certifikatës së kandidatit si mjet verifikimi për të qenë banor i bashkisë ku kandidon deri në afatin e fundit ligjor të miratimit, u morrën masa për pajisjen e KZAZ-ve me shërbim interneti dhe në bashkëpunim me DPGJC u mundësua që nëpërmjet një aplikacioni të thjeshtohet procesi i verifikimit, direkt në serverin ku administrohet lista e zgjedhësve. Trajnimi për mënyrën e verifikimit u bë vetëm nëpërmjet faqes së internetit të KQZ-së.

Në përfundim mund të themi se ky proces pati dhe problematikat e veta, e lidhur kjo me faktin e vendimmarrjes së KQZ-së për mosregjistrimin apo regjistrimin të kandidatëve për kryetar të njësisve vendore dhe kandidatë për këshillat vendore në disa zona zgjedhore, nën interpretimin e boshllëqeve ligjore që kishin dispozitat e Kodit Zgjedhor në këtë drejtim, problematika këto të trajtuara edhe në vërejtjet e raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it.

Si rezultat i kësaj vendimmarrje vëzhguesit e Kongresit të Autoriteteve Lokale të Këshillit të Europës në raportin përfundimtar, rekomandojnë ndryshime në Kodin Zgjedhor, për të siguruar mundësi të barabarta garimi për të gjitha subjektet zgjedhore duke veçuar kandidatët apo partitë që duan të garojnë jashtë koalicioneve të mëdha, kjo **siç e theksojnë ata** për të siguruar barazinë e votës të qytetarëve, pra KQZ-ja sipas tyre ka cënuar barazinë e votës se qytetarëve me vendimmarrjen e saj.

I.10.2 Regjistrimi i votuesve

Kodi Zgjedhor i ka caktuar KQZ-së një rol mbikëqyrës në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Këtë rol KQZ e ka realizuar duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore gjatë procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve dhe duke ndërhyrë kur e ka parë të nevojshme. Gjithashtu, mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë në veprimet që bëhen në bazën e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile për hartimin e listave të zgjedhësve, KQZ e ka bërë nëpërmjet dy auditëve teknikien të emëruar sipas përcaktimeve që bënë Kodi Zgjedhor. Veprimtaria e auditëve teknikien është rregulluar me një akt normativ të miratuar nga KQZ. Raportet periodike mujore të auditëve teknikien janë diskutuar në mbledhjet e KQZ-së me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Problemet e dala gjatë diskutimit të raporteve të auditëve teknikien janë adresuar për zgjidhje si në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësitë përkatëse vendore. Në mënyrë të përmbledhur problemet e dala gjatë mbikëqyrjes së përgatitjes së listave të zgjedhësve nga KQZ-ja janë si më poshtë:

- Ekzistenca ende, në listat e zgjedhësve, të zgjedhësve të dubluar. Nga raporti i parë i auditëve teknikien shifra për zgjedhësit e dubluar ishte 3900, në listën përfundimtare ky numër u reduktua në 1191 dublime. Procesi i pastrimit të listave të zgjedhësve nga rekordet e shumëfishta (të dubluara) është i vazhdueshëm që bëhet nga DPGJC dhe zyrat e gjendjes civile edhe në periudhë jo zgjedhore. Ky numër vjen vazhdimisht në zvogëlim.
- Ekzistenca ende, në listat e zgjedhësve, të zgjedhësve pa kod vendbanimi (adresë e zgjedhësit). Siç dihet kodi i vendbanimit është një nga përbërësit zgjedhor të zgjedhësve që është i përfshirë në përbërësit e gjendjes civile në RKGJC-së. Ky kod është caktuar në bazë të ligjit Nr.9296. datë 21.10.2004 "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore". Kodi i vendbanimit shërben për përcaktimin e qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Shtetasit që nuk janë gjendur ose nuk gjenden në adresën që kanë deklaruar se banojnë nuk ka mundësi të pajisen me këtë kod. Kryesisht zgjedhësit pa kod vendbanimi janë ata që kanë emigruar jashtë shtetit. Megjithë përpjekjet e bëra nga njësitë e qeverisjes vendore numri i zgjedhësve pa kod vendbanimi është ende i lartë. Në listën përfundimtare të zgjedhësve ishin 300.506 zgjedhës që u mungonte ky kod nga **3.372.471 zgjedhës gjithsej në listën e zgjedhësve** ose 8,92% e gjithë zgjedhësve.
- Krijimi i panevojshëm i qendrave të reja të votimit, në kundërshtim me kriteret ligjore, nga disa kryetarë të njësive vendore. Siç dihet kryetari i njësisë vendore kur një zonë qendre votimi ka mbi 1000 zgjedhës vendos për krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda të njëjtës zonë. U vërejt që veçanërisht në qarkun Tiranë disa kryetarë të njësive kishin krijuar qendra votimi shtesë edhe në rastet kur numri i zgjedhësve në zonën e qendrës së votimit nuk i kalonte 1000 zgjedhës. Me ndërhyrjen e KQZ-së ky fenomen u normalizua.
- Mospërfshirja e një numri të konsiderueshëm zgjedhësish në listën e zgjedhësve të institucioneve të vuajtjes së dënimeve. Siç dihet përfshirja e kësaj kategorie zgjedhësish në listën e zgjedhësve është rregulluar me ligjin për gjendjen civile. Që në momentin e vuajtjes së shtetasit në këto institucione, drejtuesit e tyre duhet të bëjnë regjistrimin në zyrën e gjendjes civile të njësisë ku ndodhet institucioni dhe automatikisht ata janë të përfshirë në listat e zgjedhësve. Një gjë e tillë nuk ishte bërë në kohën e duhur nga disa drejtues të këtyre institucioneve. KQZ bashkëpunoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe DPGJC-në për ta zgjidhur këtë problem por përsëri, brenda afatit të shpalljes së listës së zgjedhësve, ngeli një numër i konsiderueshëm prej tyre pa u regjistruar. Për këtë arsye 2256 të burgosur u desh të pajisen me vendim të gjykatave përkatëse për të votuar në QV-të e ngritura në institucionin ku vuajnë dënimin.
- Rritja e dyshimtë një muaj para zgjedhjeve e numrit të zgjedhësve në bashkinë Durrës dhe Kavajë. Nga studimi që bëri një nga auditët teknikien të dinamikës së ndryshimit të numrit të zgjedhësve në periudhën e rishikimit të listës së zgjedhësve, u vërejt që për një muaj në

bashkinë Durrës kishte një rritje prej 2186 zgjedhës dhe në atë të Kavajës 595 zgjedhës, shifra këto shmë më të mëdha se rritjet në muajt e mëparshëm. Duke qenë se auditi paraqiti prova shkresore për regjistrime të dyshimta të zgjedhësve në këto bashki, KQZ ja percolli materialet prokurorive përkatëse për të hetuar si ishte e vërteta. Gjithashtu, nga një subjekt zgjedhor u prezantua në mbledhjen e KQZ-së, se edhe në bashkinë Vorë kishte patur një shtesë të dyshuar fiktive për 500 zgjedhës, pretendime këto të verifikuara nga specialistë të DPGJC-së të cilët gjetën shkelje në këtë proces dhe ja percollën prokurorisë përkatëse.

1.10.3 Ankimimet për procesin e regjistrimit

Numri i kërkesave ankimore të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve është gjithsej 23. Objekti i ankimeve gjatë kësaj periudhe i krahasur me numrin e ankimeve (58 ankime) për të njëjtën periudhë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të vitit 2011 është ulur me 60 %. Reforma territoriale, sipas të cilës vendi u nda në 61 njësi vendore nga 384 në zgjedhjet e vitit 2011, sigurisht dha efekte dhe në lehtësimin e administrimit të ankimeve zgjedhore, gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve. Reforma territoriale, u shoqërua me ndryshime minimale të Kodit Zgjedhor, mungesa e një dispozite tranzitore për saktësimin e kushteve të kandidimit, si pasojë e heqjes së Komunitetit si njësi vendore, në disa raste solli problematika në zbatimin e dispozitave. Këto probleme u shfaqën për regjistrimin e kandidatëve të propozuar nga partitë politike të cilat zotëronin mandate vetëm në organet e ish-komunave, (kryetar, këshill) tashmë njësi administrative të bashkive, për të cilat do të kandidonin.

Gjithashtu, procesi i regjistrimit të kandidatëve për kryetar dhe listave shumemërore të kandidatëve për këshillat e bashkive, nxorri problemin e institutit të dorëheqjes dhe zëvendësimit të kandidatëve.

Kjo problematike e evidentuar dhe nga raporti i OSBE-ODIHR, është trajtuar gjerësisht nga KQZ, duke parashikuar dhe rekomandimet konkrete për ndryshimet e mundshme në Kodin Zgjedhor.

Në çdo rast kur kërkesa ankimore kishte indicie të mjaftueshme nga provat e paraqitura, fakte dhe argumenta bindëse, KQZ ka thelluar hetimin administrativ, duke ju drejtuar institucioneve të specializuara, për të siguruar prova nga të tretët, duke këqyruar të gjithë dokumentacionin zgjedhor.

Nga 23 kërkesat ankimore të paraqitura

- Për 18 kërkesa ankimore është vendosur pranimi për shqyrtim prej KQZ-së.
- Për 5 kërkesa ankimore është vendosur mospranimi për shqyrtim.

Seleksionimi i kërkesave ankimore sipas objektivit,

- 11 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së, për mos/regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkie"
- 2 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin e vendimit të KZAZ për mosregjistrimin e Komitetit Nismëtar"
- 8 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin ndaj vendimit të KZAZ-së, për mosregjistrimin e listave shumemërore për Këshillin e Bashkisë"
- 2 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin ndaj mosmarrjes vendim prej KZAZ-së, për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkie".

Për 4 raste KQZ, bazuar në nenin 21, pika 26 të Kodit Zgjedhor, vendosi kthimin e dokumentacionit pranë KZAZ-ve, për marrjen e vendimit përfundimtar për regjistrimin e

kandidatëve, pasi kryerja e kësaj procedure është kompetencë e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë.

Neni 21, pika 26 e Kodit Zgjedhor, ka ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, i cili erdhi si rrjedhojë e rekomandimit të raportit të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2011.

Kundër vendimeve të KQZ-së për shqyrtimin e kërkesave ankimore për regjistrimin e kandidatëve u paraqitën gjithsej 13 ankime në Kolegjin Zgjedhor, pranë gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Zgjedhor, nga 13 ankimet e paraqitura:

Për 7 vendosi rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së,

Për 3 ankime vendosi pranimin e padisë dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së.

Për 1 ankim vendosi detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

Për 1 ankim pranimin e pjesëshëm të padisë (*detyrimin e KQZ-së për të pranuar dokumentacionin e regjistrimit të listës shumëmemrore, pa qenë e nevojshme depozitimi i listave me nënshkrimet e zgjedhësve mbështetës*).

II PJESA E DYTË – PERIUDHA ZGJEDHORE


II.1 Akreditimi i vëzhguesve

Në vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2015, u angazhuan një numër relativisht i lartë vëzhguesish si vendas ashtu dhe të huaj. Për ndjekjen e procedurave të akreditimit të vëzhguesve vendas dhe të huaj, u bazuam në **Udhëzimin e KQZ Nr.13, datë 22.04.2009**, mbi përcaktimin e rregullave të vëzhgimit të procesit zgjedhor, akreditimit, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat jofitimprurëse shqiptare, organizmat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore morën pjesë 16 Organizata Lokale dhe 2 koalicione të cilët akredituan vëzhguesit e tyre : 1,487 afatgjatë; 2,082 afatshkurtër dhe 683 vëzhgues nga Media. Gjithsej në total u akredituan **4252** vëzhgues vendas.

Vëzhguesit e organizmave Ndërkombëtarë: Gjithsej **933** vëzhgues ndërkombëtar nga të cilët 88 vëzhgues afatgjatë të akredituar, 638 janë vëzhgues afatshkurtër dhe 207 përkthyes të akredituar.

Gjithsej vëzhgues të organizata lokale dhe ndërkombëtare – 5,185 vëzhgues



Problematika

Në shumicën e rasteve akreditimi i vëzhguesve u krye në kufijtë kohorë të afateve të përcaktuara nga KQZ, gjë që gjithashtu lë të nënkuptosh dhe mosmarrjen e njohurive të

duhura lidhur me procesin zgjedhor, e lidhur kjo me numrin e OJF-ve të cilat janë paraqitur në KQZ për të akredituar një numër të madh vëzhguesish.

Organizata të cilat janë angazhuar për herë të parë nëpërmjet projekteve, nismave të tyre apo në kuadër të angazhimit si pjesë e koalicioneve të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve, shihet një prurje vullnetare e aktivistëve.

Sugjerohet

- E shikojmë të domosdoshëm një trajnim më të organizuar dhe efikas, duke parashikuar një seancë të përgjithshme për përfaqësues të organizatave të cilët pastaj nga ana e tyre ta replikojnë në seanca specifike brenda organizatave të tyre. Ky trajnim duhet të fokusohet në elementët ligjor të ecurisë së procesit zgjedhor lidhur me dispozitat që parashikon KZ dhe legjislacioni në tërësi, në të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve, kodin e etikës si dhe në raportimin e të dhënave.
- E rëndësishme është që trajnimi duhet të shoqërohet dhe me manualin/udhëzuesin e vëzhguesve për të përforcuar informacionin e komunikuar gjatë programit të trajnimit. Vullnetarët përfitojnë nga materiali i shkruar dhe mund t'i referohen edhe pasi sesioni i trajnimit të ketë mbaruar. Një manual i shkruar mirë duhet të përshkruajë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e vëzhguesit (shiko udhëzuesin e vëzhguesit).
- E parë ndoshta nga një këndvështrim tjetër, trajnimi i vëzhguesve, është i lidhur ngushtë me sasinë e fondeve në dispozicion. KQZ-ja, nuk ka patur një fond të posaçëm për të organizuar trajnime për vëzhguesit. Prandaj dhe ngritja e një Qendre Trajnimi do të ishte në funksion dhe të trajnimit të këtij target grupi.

II.2 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit

KQZ-ja pas shqyrtimit të propozimeve të ardhura nga Organizatat joFitimprurëse, vendosi ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias. Bordi i Monitorimit të Medias në zgjedhjet e datës 21 Qershor 2015, paraqiti në KQZ jo vetëm raportet javore por edhe raporte ditore, të cilat u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së, iu dërguan të gjithë mediave dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare të akredituara për vëzhgimin e zgjedhjeve. Raportet ditore të BMM, ndihmuan operatorët audio-vizivë që të kontrollonin veten e tyre përse i përket minutazhit që ato transmetonin për secilin subjekt zgjedhor.

KQZ-ja mori në shqyrtim çdo javë raportet e BMM-së, në të cilat propozimet e Bordit të Monitorimit vinin me konsensusin e të gjithë anëtarëve. BMM-ja propozoi marrjen e masave për subjektet transmetuese, duke kërkuar kompensimin në favor të subjekteve zgjedhore, si dhe identifikimin e qartë të subjektit zgjedhor në reklamat për pasqyrimin e fushatës zgjedhore.


KQZ në dy javët e para të monitorimit nuk miratoi propozimet e BMM për vendosjen e gjobave për TV por iu dha kohë operatorëve audio-vizivë që të kompensojnë kohën (pavarësisht se Kodi Zgjedhor kompensimin e kohës e parashikon vetëm për televizionin publik shtetëror, RTSH), duke shmangur dënimin e TV-ve dhe duke përcjellë mesazhin se mediat mund të respektonin Kodin Zgjedhor pa u dënuar me gjoba. Dënimi i TV-ve me gjoba nga ana e KQZ-së mund të çonte deri në mbylljen e aktivitetit të operatorëve audio-vizivë, ndaj KQZ gjykoi se televizionet mund të kompensojnë kohën për subjektet.

Për herë të parë një javë përpara datës së zgjedhjeve, BMM në raportin progresiv të datës 13 qershor konstaton se operatorët radiotelevizivë publik dhe privat, kombëtar dhe lokal kanë arritur kryesisht balancimin në raportet kohore të pasqyrimin të fushatës midis partive politike.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit të tretë dhe të fundit të BMM (risi ishte dorëzimi i raportit të IV-t të monitorimit nga BMM, pra javës së katërt të monitorimit, ku përfshihej edhe dita e heshtjes zgjedhore dhe dita e votimit), ishin jo vetëm konsensuale (të firmosura nga 7 anëtarët e BMM, fakt i pa ndodhur më parë si në zgjedhjet e 2011 dhe as në zgjedhjet 2013) por ishin të qarta, dhe rigoroze në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

KQZ shqyrtoi katër raporte javore, ku në 3 raste ka vendosur sanksione administrative me gjobë për 3 operatorë televiziv si më poshtë vijon:

- 1- Skampa TV në vlerën: 3.5 (tre pikë pesë) milion
- 2- Vlora Channel në vlerën: 2 (dy) milion
- 3- Antena Nord në vlerën: 1.5 (një pikë pesë) milion



Deri tani operatorët televizive, Skampa TV dhe Vlora Channel e kanë kundërshtuar, vendimin e KQZ për vendosjen e sanksioneve administrative në Gjykatën Administrative. Gjykata administrative në të dy rastet ka lënë në fuqi vendimin e KQZ-së.

II.3 Akses i medias

Transparenca e veprimtarisë së KQZ-së, për vet misionin që ky institucion përmbush, është një nga garancitë për rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Veçanërisht në një vit zgjedhor, interesimi i publikut dhe medias për aktivitetin e KQZ-së rritet ndjeshëm. Pasqyrimi i zgjedhjeve nga media është një faktor vendimtar në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike pasi qëllimi final i pasqyritit në media i veprimtarisë së KQZ-së dhe fushatës zgjedhore, është informimi i drejtë i votuesve dhe transparenca për publikun.

Media pasqyron aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, shpërndan informacion mbi vendimmarrjen e KQZ, platformat e partive politike apo kandidatëve të pavarur dhe informacion që edukon zgjedhësit shqiptar.

Seancat e mbledhjeve të KQZ janë përherë publike, kanë gjithmonë vëmendjen dhe praninë e medias dhe mund të ndiqen drejtpërdrejt nga faqja zyrtare e internetit të KQZ-së. Në kuadër të kësaj transparence, KQZ ka përdorur të gjitha mënyrat e komunikimit për njoftuar rregullisht dhe në kohë, jo vetëm subjektet zgjedhore, por edhe të gjitha mediat e shkruara dhe audiovizive. Të gjitha njoftimet për mbledhjet e KQZ-së, nuk janë thjesht të karakterit formal për kohën e zhvillimit të tyre, por shoqërohen përherë me dokumentacionin përkatës, objekt shqyrtimi në rendin e ditës. Përgjithësisht, kjo transparenca ndihmoi në mirëinformimin e opinionit publik, por ka patur raste që si rezultat i mosnjohjes apo moskuptimit të ligjit zgjedhor, vendimmarrja e KQZ-së nuk u përcoll në mënyrë të saktë dhe korrekte.

Në zgjedhjet e datës 21.06.2015, ishte risi publikimi që KQZ i bëri listave shumëmemërore të kandidatëve në faqen zyrtare përmes aplikacionit "Kandidatët", duke ofruar transparenca

maksimale jo vetëm për mediat, por edhe për publikun lidhur me kandidatët të cilët garonin në zgjedhje.

Ashtu si në zgjedhjet e vitit 2013, një faktor i rëndësishëm në rritjen e transparencës së veprimtarisë së KQZ-së, ishte publikimi i rezultatit paraprak dhe atij përfundimtar. Të gjitha mediave, si dhe çdo qytetari të interesuar, iu dha akses direkt nga ekranet e KQZ-së, brenda dhe jashtë ambienteve të saj. Kjo infrastrukturë transparente, nëpërmjet medias, i erdhi në ndihmë të gjithë opinionit publik, pasi ishte vet media që në transmetimin e rezultateve i referoheshin të dhënave zyrtare të pasqyruara nga KQZ.

Në zgjedhjet vendore të 21 Qershorit 2015, në faqen zyrtare të KQZ-së, u krijua rubrika e Raporteve të BMM, ku çdo ditë hidheshin raportet e monitorimit të televizioneve përsa i përket transmetimit të fushatës, duke bërë të mundur informimin në kohë të çdo operatori lidhur me ecurinë e tij gjatë monitorimit.

Çdo informacion i cili përbën interes për publikun dhe median është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, duke i ofruar aksesin e nevojshëm të gjithë të interesuarve.

II.4 Fleta e Votimit

KQZ duke vlerësuar integritetin e fletës së votimit, si një nga elementët që ndikon drejtpërsëdrejti në standartet e procesit zgjedhor, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor i kushtoi rëndësi të veçantë përcaktimit të specifikimeve të fletës së votimit, procesit të përgatitjes së fletëve të votimit, integritetit të prodhimit dhe më tej, shpërndarjes së tyre.

KQZ, në përmbushje të detyrave të veta, me vendimin nr.104, datë 09.04.2015, miratoi modelin dhe specifikimet teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet vendore 2015. Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, në këto specifikime u përfshinë veç të tjerash dhe shënimi i numrit të qendrës së votimit e i Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës. Gjithashtu, fleta e votimit kishte elemente identifikuese të cilat nuk lexoheshin me sy të lirë në formën e barkodeve.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, KQZ pati parasysh eksperiencat e zgjedhjeve të mëparshme vendore për sa i përket numrit të subjekteve zgjedhore të regjistruara në fletën e votimit. Në përfundim të procesit të regjistrimit të listave shumëpartiake nga partitë politike dhe kandidatëve për kryetar nga partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për çdo njësi të qeverisjes vendore, rezultoi se numri i tyre ishte shumë më i madh se në zgjedhjet e mëparshme vendore. Në fletën e votimit për këshilltarë numri i subjekteve zgjedhore ishte: më i vogli 9 në bashkinë Pustec dhe më i madhi 55 subjekte në bashkinë Tiranë (në zgjedhjet vendore 2011 numri maksimal i subjekteve në fletën e votimit për këshilltarë ka qënë 38). Në fletën e votimit për kryetar bashkie numri i kandidatëve ishte më i madhi, 5 kandidatë në bashkinë Tiranë.

Në këto kushte disa specifikime të modelit të fletës së votimit, veçanërisht të asaj për këshilltarë, u desh të ndryshohen për t'u përshtatur me numrin e subjekteve zgjedhore që merrnin pjesë në zgjedhje.

Zgjedhjet vendore 2015, ishin të parat që organizoheshin pas ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, ku emrat e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit renditen të përcaktuara në mënyrë të rastësishme nga shorti dhe jo në rend alfabetik siç ka qënë më parë.

Për këtë KQZ miratoi Udhëzimin nr.3, datë 4.03.2015 "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit". Në këtë Udhëzim u miratua që shorti për renditjen në fletën e votimit për këshilltarë të përcaktonte një numër rendor unik për çdo subjekt zgjedhor për të gjitha bashkitë, ndërsa për kryetar shorti për

renditjen në fletën e votimit të hidhej për çdo bashki më vete. KQZ në një seancë publike me pjesëmarrjen e të gjithë subjekteve zgjedhore hodhi shortin për renditjen në fletën e votimit për këshilltarë dhe me Vendim nr.438, datë16.5.2015 miratoi këtë renditje. Shorti u hodh për 77 subjekte zgjedhore (63 parti politike që kishin paraqitur listë shumemërore për këshilltarë të paktën në një bashki dhe 14 kandidatë të propozuar nga zgjedhës). Për renditjen e kandidatëve në fletën e votimit për kryetar shorti u hodh veç e veç për të 61 bashkitë.

Për të realizuar prodhimin e fletëve të votimit sipas përcaktimeve ligjore, u kryen procedurat përkatëse tenderuese dhe, fituese rezultoi një kompani e huaj. Në bazë të kontratës me kompaninë fituese, KQZ, ndër të tjera, duhej të dërgonte në kohën e duhur të gjithë informacionin e saktë që përfshinte përmbajtjen e fletës së votimit, numrin e QV-ve, numrin e zgjedhësve për çdo QV etj. Në disa raste informacioni i nevojshëm nuk u dërgua në kohë, kjo erdhi kryesisht nga vonesat në regjistrimin përfundimtar të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetar kur bëheshin ankime deri në Kolegjin Zgjedhor, por edhe vonesat për numrin e QV-ve dhe zgjedhësit në to. Për këto të fundit problematik serioze shkaktuan QV-të e posaçme në institucionet e vuajtjes së dënimeve. E gjithë kjo problematikë e vuri KQZ-në në vështirësi ekstreme për prodhimin e fletëve të votimit. Në këto zgjedhje ndodhi që një ditë para ditës së votimit KQZ-së i erdhi njoftimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve se në disa qendra votimi të posaçme në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ishte shtuar së tepërmi numri i zgjedhësve. Arsyeja e kësaj shtese ishte se shtetasit që vuanin dënimin në këto institucione nuk ishin regjistruar nga drejtuesit e institucioneve në kohën e duhur në zyrat përkatëse të gjendjeve civile dhe kishin ngelur pa u përfshirë në listat e zgjedhësve të njësisë përkatëse. Pasi kishin bërë kërkesë në gjykatë këta shtetas ishin pajisur me vendim gjykate për të votuar në QV-të përkatëse. Në këto kushte, KQZ duhet të merrte masa të siguronte fletë votimi për të mundësuar votimin e shtetasve të sipërcituar. Për zbatimin e vendimeve gjyqësore u desh të ngriheshin edhe dy QV të posaçme, një në institucionin e vuajtjes së dënimit në Rrogozhinë dhe një në atë të Peqinit, me përkatësisht 420 dhe 400 zgjedhës. Në pamundësi për prodhimin e fletëve të votimit shtesë, KQZ-së ju desh të merrte Vendimin Nr.723, datë 21.06.2015, ora 00:30 "Për sigurimin e fletëve të votimit shtesë për disa qendra votimi të posaçme" ku autorizoheshin KZAZ-të që me vendim të bënin pajisjen e QV-ve përkatëse me sasinë e duhur të fletëve të votimit duke marrë ato nga QV të tjera.

Gjatë gjithë procesit që kishte të bënte me fletën e votimit, KQZ u kujdes të plotësonte me durim të gjitha kërkesat dhe të shuante të gjithë dyshimet e forcave politike lidhur me integritetin maksimal të fletës së votimit. Për këtë, veç të tjerash, KQZ u mundësoi të gjitha partive politike të interesuara të vëzhgonin nga zyrat e tyre nëpërmjet pamjeve me figurë, vazhdimisht, natën dhe ditën, procesin e punës me fletët e votimit që nga momenti i futjes në magazinën e KQZ-së në Lundër, shpërndarjen në KZAZ-të përkatëse, kthimin e tyre pas votimit në magazinë deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Kjo u bë e mundur nëpërmjet kamerave cilësore të vendosuar në ambientet e magazinës dhe shërbimit me internet për kalimin e pamjeve në kompjuterat e partive politike sipas një procedure të caktuar.

Edhe në zgjedhjet vendore 2015 fleta e votimit kishte elementë sigurie të përafërt me kartmonedhat, gjë e cila tregon se sa shumë punë kemi akoma për të rritur besueshmërinë të procesit.

Procesi i përgatitjes, prodhimit dhe shpërndarjes së fletëve të votimit për zgjedhjet vendore 2015, proces i cili pavarësisht problemeve sa më lartë, u realizua në kohë dhe me standardet e kërkuara, kjo falë vëmendjes dhe masave të ndërmarra nga KQZ.

II.5 Përgatitja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KQV.

Një nga detyrat kryesore të KQZ-së është dhe shpërndarja e bazës materiale të logjistikës zgjedhore në të gjithë KZAZ-të. Duke qenë se KQZ-ja e ka të pamundur ta përballojë me kapacitetet e veta këtë proces, referuar eksperiencës në vite ky proces është kryer në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit që KQZ-ja ka nënshkruar me Këshillin e Ministrave.

Në sajë të koordinimit të mirë me përfaqësuesit e kësaj Ministrie, u bë i mundur transporti periodik i shtrirë në disa ditë në bazë Qarku, ç'ka bëri të mundur një shfrytëzim me efektivitet të burimeve në dispozicion duke bërë të mundur shpërndarjen në kohë me të gjithë materialet zgjedhore të përgatitura.

Edhe pse kushtet atmosferike nuk ishin në favorin tonë (dy ditë pati reshje të dendura), falë masave të marra u arrit që transporti të kryhej pa asnjë problem dhe pa dëmtime të materialeve zgjedhore.

Të 90 KZAZ-të morën në dorëzim bazën materiale minimalisht 3 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në asnjë rast nuk pati probleme në shpërndarje apo në mosmarrjen në dorëzim të materialit.

Më datë 20 qershor, të gjitha KZAZ-të realizuan shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore për KQV-të. Vonesa në shpërndarje pati vetëm në ato raste kur partitë politike ndërruan në momentet e fundit anëtarët e komisioneve të QV-ve, sikundër ndodhi për disa QV të KZAZ-ve nr.26 dhe nr.29, apo për shkak të propozimeve të vonuara për emërimin e anëtarave të KQV-ve sikundër ndodhi në KZAZ-të e qarkut Shkodër.

Rasti më problematik ishte KZAZ nr.15, qarku Lezhë, e cila filloi shpërndarjen e bazës materiale pas orës 24:00. të datës 20.06.2015.

II.6 Dita e zgjedhjeve

Procesi i votimit shënoi rritje të padiskutueshme të standardeve demokratike, kjo sa i përket administratës zgjedhore e cila dëshmoi profesionalizëm, respektoi dhe zbatoi korrektësisht Kodin Zgjedhor, por edhe nga qytetarët shqiptarë, me pjesëmarrjen dhe kulturën në votim.

Në këto zgjedhje, nuk u referua asnjë rast të zgjedhësve të cilët nuk ishin në listën e zgjedhësve apo të cilët kishin patur probleme me gjetjen e qendrës së tyre të votimit. Në të gjitha rastet fluksi i zgjedhësve në qendrat e votimit ka qenë i përballueshëm nga komisionet e qendrave të votimit, nuk pati incidente, pezullim apo ndërprerje të votimit në atë masë që të shkaktonin pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Në përgjithësi qendrat e votimit u hapën në orarin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Zgjedhjet nuk u zhvilluan vetëm në QV nr.22242 (qendër votimi e posaçme) të KZAZ nr.43, e cila nuk arriti të merrte vendim për ngritjen e komisionit të kësaj qendre votimi. Megjithë urdhërimin e KQZ-së dhe asistencën e përfaqësuesve të KQZ-së nuk u arrit që të ngrihej dhe të funksiononte kjo qendër votimi, brenda afateve ligjore të përcaktuar në kod.

U përdorën gjithsej 6 vula rezervë për qendrat e votimit, për shkak të humbjes së tyre, krijimit të qendrave të votimit të posaçme.

Nuk pati asnjë rast të braktisjes së detyrës nga komisionerët.

Pati QV ku u evidentuan mungesa të fletëve të listës së zgjedhësve. U kontaktuan njësitë e qeverisjes vendore dhe problemet u zgjidhën në kohë të shkurtër. Probleme teknike në fletën e votimit, të evidentuara në KZAZ nr.60, qarku Fier (në fletën e votimit për kryetar të bashkisë, tek koalicioni idjathtë figuronte emri i kandidatit të koalicionit të majtë, ndërsa emrat e partive pjesëtare ishin të sakta), në KZAZ nr.77, qarku Gjirokastër (fleta e votimit për kryetarin e bashkisë, numrat rendorë të tre kandidatëve pasqyroheshin 1; 2 ;2) apo në KZAZ

nr.70, qarku Fier (në fletën e votimit për këshillin e bashkisë të dy koalicionet pasqyroheshin me të njëjtin emër) u shqyrtuan menjëherë nga KQZ dhe u vendos që votimi të vazhdonte. Për qetësinë dhe rregullin e ecurisë së procesit të votimit, dëshmon dhe mungesa totalisht e referimeve të problematikave nga partitë politike, apo KZAZ-të, pasi nuk është paraqitur asnjë kërkesë/ankesë për ndërhyrje të KQZ-së me autoritetin e vet ligjor si nga subjektet zgjedhore ashtu dhe nga KZAZ-të.

Procesi i votimit u mbyll në orës 19:00 dhe nuk nuk u raportuan vonesa në mbyllje.


II.7 Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së

Transporti i kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore dhe dorëzimi i tyre nga KQV-të në VNV përfundoi rreth orës 24:00, të datës 21 qershor 2015. Kriteri i barazlargësisë së VNV nga qendrat e votimit, kushtet fizike dhe infrastrukturore të VNV-ve, e ndihmuan këtë proces.


II.8 Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ.

Në përgjithësi procesi i numërimit të votave shkoi shumë mirë. Siguria në vendet e numërimit të votave ka qenë në të gjitha rastet në lartësinë e kërkuar, edhe në sajë të punës së Policisë së Shtetit. Në shkallë vendi, numërimi i votave për kryetar bashkie përfundoi brenda 4 ditëve, ndërsa numërimi i votave për këshillat bashkiakë u krye brenda 6 ditëve. Numërimi, ndonëse nuk u përmbyll në afatin ligjor, shfaq trend përmirësimi: në vitin 2013, që ishte vetëm një kuti votimi (pra 1 fletë votimi për t'u numëruar), procesi i numërimit u mbyll brenda 7 ditësh, ndërsa në vitin 2011 procesi i numërimit ka zgjatur 14 ditë. Vota të pavlefshme për kryetar të bashkive ishin 2.5% e totalit, dhe për këshill 3.7% e totalit, kundrejt 2.88% të votave të pavlefshme për kryetarin dhe 2.88% të votave të pavlefshme për këshillin që rezultuan në zgjedhjet e vitit 2011.

Numërimi i kutive të Kryetarit të Bashkisë përfundoi sipas grafikut:



Numërimi i kutive të Këshillit të Bashkisë përfundoi sipas grafikut:



Probleme që ndikuan në zgjatjen e procesit të numërimit:

- Prania shumë e madhe e vëzhguesve në VNV, për më tepër e personave politikë, presionit që këta vëzhgues ushtronin ndaj grupeve të numërimit. Në disa VNV, KZAZ-të kërkuan ndihmën e policisë së shtetit për normalizimin e situatës.
- Ndërprerje për shkak të pjesëmarrjes së personave politikë në VNV, të cilët urdhëronin numëruesit e subjekteve zgjedhore të propozuar prej tyre të ndërprisnin apo ngadalësonin herë pas here numërimin e votave;
- Lodhjes së numëruesve pasi shumica e tyre kishin shërbyer dhe si komisionerë në qendrat e votimit. Ndërprerjet e procesit të numërimit kanë qenë më të shpeshta në KZAZ-të të cilat kishin shumë qendra votimi dhe shumë votues dhe kjo ka ardhur si pasojë e lodhjes së komisionerëve të KZAZ-së dhe të grupeve të numërimit.
- Kushtet e ambienteve të punës, i nxehti/temperaturat/mbipopullimi;
- Konflikte, edhe të dhunshme ndërmjet vëzhguesve të partive politike dhe komisionerëve.
- Sjellje jo ligjore të numëruesve, për shkaqe personale apo urdhërime politike.
- Probleme teknike të sistemit të aplikuar për hedhjen e të dhënave;
- Shpërndarja e pabarabartë e ngarkesës në KZAZ të ndryshme (nga 8 QV në 124 QV).

KQZ, ka ndjekur dhe menaxhuar situatën në dinamikë, dhe me të gjitha mënyrat, komunikim me telefon apo inspektimeve, ka dhënë konsulencën ligjore për mënyrën e trajtimit të rasteve të caktuara, duke realizuar rifillim sa më të shpejtë të procesit, duke shmangur tensionimet apo bllokimet e procesit. KQZ, në ushtrim të plotë të autoritetit, me proaktivitet urdhëroi që numërimi i votave për këshillin e bashkisë në KZAZ nr.1, qarku Shkodër, të kryhej në Tiranë. Ky urdhërim solli normalizimin e situatës, përfundimin e numërimit dhe nxjerrjen e rezultatit brenda ditës, dhe i dha fund stërzgjatjes së procesit të numërimit në KZAZ nr.1, e cila po mbante peng përfundimin e numërimit në shkallë vendi.

Çfarë mund të konsiderohet në kuadër të përmirësimit:

1. Kodi Zgjedhor duhet të ndalojë që komisioneri i KQV të emërohet edhe si numërues. Angazhimi i burimeve njerëzore për dy aspekte të procesit, si anëtarë të QV dhe si numërues, puna intensive, me përgjegjësi, në vijueshmëri dhe me orare të zgjatura, padyshim reflekton lodhje dhe rënie të ritmit gjatë procesit të numërimit.
2. Për KZAZ-të me numër të madh QV, zgjidhje do të ishte shtimi i numrit të tavolinave. Kjo do të kërkonte ndryshime të Kodit Zgjedhor, por edhe do të paraqiste vështirësi për sigurimin e ambienteve me sipërfaqe të mjaftueshme.
3. Afati i përcaktuar në Kodin Zgjedhor për përfundimin e procesit të numërimit, duhet të rishikohet, pasi duke konsideruar hipotetikusht se çdo procedurë shkon në normalitet, pa kontestime, pa mungesa që detyrojnë hapjen e kutive të materialeve të votimit, ky afat ligjor nuk mund të arihet¹³.

Vetëm me këtë kohë fizike të kërkuar për shfaqjen në monitor, konsumohet afati ligjor "për përfundimin e votimit brenda orës 24:00 të ditës së nesërme". Ndërkohë që procedurat e tjera si hapja, shpalosja e fletëve të votimit, numërimi dhe rinumërimi nqs kërkohet, numërimi i votave për secilin subjekt, tabelimi i rezultateve, nënshkrimi i tabelës dhe plotësimi i vërejtjeve, plotësimi i procesverbalit, procedurat e mbylljes së kutisë, marrja/dërgimi i kutisë në vendin e caktuar, dorëzimi i tabelës së rezultatit dhe korrigjimi i shifrave nqs shifrat nuk përputhen, janë shumë procedura që kërkojnë tjetër kohë fizike, pa përmendur këtu rastet e kontestimit dhe rivlerësimit.

Në përfundim theksojmë se, numërimi i votave në VNV ka rritur besimin e subjekteve zgjedhore dhe të zgjedhësve se numërimi është korrekt dhe i sigurtë. Numërimi i votave në ambiente të përqendruara sipas zonave të administrimit të zgjedhjeve në transparencë të plotë (përdorimi i kamerave dhe ruajtja e regjistrimeve), ka rritur përgjegjëshmërinë e numëruesve. Ndryshimet e papërfillshme të rezultateve pas rinumërimit të votave të disa QV-ve, tregojnë për respektimin korrekt të procedurave ligjore nga ana e administratës zgjedhore.

II.9 Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar.

Kodi Zgjedhor përcakton detyrimin e KQZ-së për të transmetuar elektronikisht rezultatet paraprake të zgjedhjeve menjëherë sa bëhet tabulimi i rezultatit të çdo QV-je. Për këtë në të gjitha VNV-të nëpërmjet pajisjeve të teknologjisë së informacionit është mundësuar komunikimi online me serverin e KQZ-së. Mbi bazën e Udhëzimit të KQZ-së Nr.1, datë 20.02.2015 "Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin elektronik të informacionit për rezultatet paraprake në dinamik" u bë përshtatja e modulit kompjuterik përkatës. Në modulën e përmirësuar mbi bazën e Udhëzimit, u krijuan kushte për ta bërë më të konsoliduar këtë

¹³ për një KZAZ me 60 QV në juridiksion (mesatarja e ngarkesës), do të kishim:

- a. 5 tavolina numërimi (secila do të numëronte 12 kuti votimi për kryetar dhe 12 kuti votimi për këshill)
- b. Për secilën kuti votimi vetëm procedurat e shfaqjes se fletëve në monitor do të kërkonin:
 - 7 sec X 500 fletë = 35 000 sec = 58.3 min = 1 orë
 - 24 kuti X 1 orë = 24 orë.

Vetëm me këtë kohë fizike të kërkuar për shfaqjen në monitor, konsumohet afati ligjor "për përfundimin e votimit brenda orës 24.00 të ditës së nesërme". Procedurat e tjera si hapja e kutisë së votimit, shpalosja e fletëve të votimit, numërimi dhe rinumërimi nqs kërkohet, numërimi i votave për secilin subjekt, tabelimi i rezultateve, nënshkrimi i tabelës dhe plotësimi i vërejtjeve, plotësimi i procesverbalit, procedurat e mbylljes së kutisë, marrja/dërgimi i kutisë në vendin e caktuar, dorëzimi i tabelës së rezultatit dhe korrigjimi i shifrave nqs shifrat nuk përputhen, kërkojnë kohë fizike të konsiderueshme. Rastet e kontestimit dhe rivlerësimit të votave gjithashtu kërkojnë kohë tjetër fizike.

proces. Trajnimi i veçantë që iu bë sekretarëve të KZAZ-ve së bashku me operatorët e kompanisë që kryen shërbimin në VNV, rriti cilësinë e zbatimit të këtij moduli dhe mundësoi që në dinamikë të transmetoheshin rezultatet paraprake e të informohej publiku si në ekranet në ambientet e KQZ-së dhe në faqen e internetit. Në këto zgjedhje, nëpërmjet këtij moduli u mundësua të jepej në rezultatet e zgjedhjeve për çdo bashki, kur kaloi numërimi i 50% të QV-ve, edhe shpërndarja e mandateve për këshillin e bashkisë.

Në procesin e hedhjes, kontrollit dhe transmetimit të rezultateve paraprake u vërejt që ka ende disa gjëra për t'u përmirësuar. U konstatua që jo nga të gjitha KZAZ-të zbatohet me rigorozitet procesi i kontrollit të hedhjes të të dhënave në sistem, ashtu si Udhëzimi i KQZ-së e përcakton. Kjo bëri që të rritej ngarkesa e punës në Qendrën e të dhënave në KQZ për të korrigjuar gabimet e bëra, që ishin më të shumta, sidomos në rezultatet për këshillin ku dhe numri i subjekteve në tabelën e rezultateve është shumë më tepër se për kryetar.

Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për bashkitë që mbulohen nga më shumë se 1 (një) ZAZ përgatitet dhe miratohet nga KQZ. Për bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Kamëz, Lezhë, Lushnjë dhe Fier, KQZ miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve si për kryetarët e bashkive dhe për këshillat bashkiak. Në këtë proces KQZ u mbështet në bazën elektronike të të dhënave të rezultatit paraprak, në tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të miratuara nga KZAZ-të, duke bërë korrigjimet sipas tabelave origjinale të rezultateve për çdo QV të plotësuar nga grupet e numërimit.

Pasi përfundoi procesi i ankimimeve për rezultatet e zgjedhjeve, KQZ përllongariti dhe me vendim miratoi shpërndarjen e mandateve për 1595 këshilltarë të 61 bashkive, mbështetur në listat shumëmemërore të partive politike. Më datën 10 gusht 2015, KQZ me vendim miratoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve vendore 2015.

II.10 Ankimet për rezultatet

Në KQZ pas datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2015 u depozituan gjithsej 92 kërkesa ankimore, nga të cilat 31 prej tyre u shqyrtuan në themel. Në çdo rast kur kërkesa ankimore kishte indicie të mjaftueshme nga provat e paraqitura, fakte dhe argumenta bindëse, KQZ, ka thëlluar hetimin administrativ, duke këqyruar të gjithë dokumentacionin zgjedhor apo dhe materialin zgjedhor të ndodhur në kutinë e materialeve zgjedhore dhe kutitë e votimit me fletët e votimit.

KQZ, për çdo ankim administrativ u investua maksimalisht, megjithëse në shumë raste, ankimet e paraqitura apo përfaqësimi i ankimesit në shqyrtimin administrativ ishte i munguar apo jo profesional, i pambështetur në dispozita ligjore, prova, fakte apo argumenta bindëse. Mjafton të përmendim se një subjekt zgjedhor depozitoi gjithsej 17 kërkesa ankimore, të cilat përshkruanin të njëjtat shkelje, fakte dhe argumenta për 17 zonat zgjedhore rezultati i të cilave ankimohej.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave ankimore për herë të parë për zgjedhjet vendore KQZ nuk shpalli të pavlefshëm zgjedhjet për asnjë qendër votimi dhe rrjedhimisht nuk u përsëritën zgjedhjet për asnjë zonë zgjedhore.

Asnjë vendim përfundimtar i KQZ-së, për shqyrtimin e kërkesave ankimore paszgjedhore nuk tejkaloi afatin ligjor 10 ditor nga data e regjistrimit të ankimit.

A Nga 92 kërkesat ankimore të paraqitura,

- Për 31 kërkesa ankimore është vendosur pranimi për shqyrtim prej KQZ-së.
- Për 34 kërkesa ankimore është vendosur mospranimi për shqyrtim.
- Për 26 kërkesa ankimore është vendosur kthimi për plotësim.

- Për 1 kërkesë ankimore subjekti politik ka hequr dorë nga kërkesa ankimore.

B Nga 31 kërkesat ankimore të pranuar për shqyrtim

- Për 1 kërkesë ankimore është vendosur pranimi i ankimit dhe ndryshimi i vendimit të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të votimit për këshillin e bashkisë Durrës.
 - Për 21 kërkesa ankimore është vendosur rrëzimi i ankimit dhe lënia në fuqi e vendimit të KZAZ-ve.
 - Për 9 kërkesa ankimore është vendosur rrëzimi i ankimit dhe lënia në fuqi e vendimit të KQZ-së, Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për kryetar/këshill.
- C Seleksionimi i kërkesave ankimore sipas objektit:

- 44 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së, për miratimin e tabelës përmbledhëse për Këshillin/Kryetarin e Bashkisë
- 1 kërkesë ankimore ka si objekt "Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar";
- 25 kërkesa ankimore kanë si objekt "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve"
- 1 kërkesë ankimore ka si objekt "Rinumërimin e kutive të votimit të specifikuar"
- 1 kërkesë ankimore ka si objekt "Kontrollin dhe verifikimin e rezultatit të tabelave përmbledhëse në disa QV të specifikuar"
- 10 kërkesa ankimore kanë si objekt "Rinumërimin e votave"
- 10 kërkesa ankimore kanë si objekt "Kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të votimit"

Jo vetëm partitë e mëdha të cilat fituan mandate në Këshillat Bashkiak, por dhe një numër i konsiderueshëm i partive të vogla ushtruan të drejtën e tyre ligjore për të kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve në një apo në të gjitha zonat zgjedhore. Në disa raste kërkesat ankimore u kthyen për plotësim pasi nuk plotësonin elemente të formës. Pjesa më e madhe e tyre u plotësuan dhe u ridedepozituan në përputhje me kërkesat ligjore. Kjo u arrit dhe si rrjedhojë e njohjes me vonesë e formateve të standartizuara të miratuara nga KQZ, por dhe konsulencës së dhënë nga sektorët përkatës në KQZ.

Ankime paszgjedhore të paraqitura nga Subjektet Zgjedhore në Kolegjin Zgjedhor:

Në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, u paraqitën nga subjektet zgjedhore 20 ankime me objekte si me poshtë:

- 5 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së për mosmarrjen për shqyrtim të kërkesave ankimore".
- 4 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së dhe ndryshimin e rezultatit përfundimtar".
- 1 ankim me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre".
- 8 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së, si për shpërndarjen e mandateve ose shpalljen e rezultateve".
- 2 ankime me objekt "Kundërshtim e vendimeve të KQZ-së dhe hapjen e kutive për disa QV".

Kolegji Zgjedhor, për ankimet sipërcituara ka vendosur;

A) Për 15 ankime është vendosur rrëzimi i ankimit dhe lënia në fuqi e vendimit të KQZ;

B) Për 2 ankime është vendosur pranimi i kërkesë padisë. Anullimi i Vendimit të KQZ-së, nga të cilat:

- 1 ankim ka si objekt "Kundërshtimi i vendimit nr.934, datë 14.07.2015 "Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Kurbini". Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur shpërndarjen e mandateve si dhe përcaktimin e mandateve nominale për çdo parti politike në bazë të projekt-vendimit të KQZ/aneksit bashkëlidhur".
- 1 ankim ka si objekt "Kundërshtimi i vendimit nr.923, datë 14.07.2015 i KQZ, për shqyrtimin e KA 108. Shqyrtimi i çështjes në themel duke vendosur shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV 092, Bashkia Shkodër. Mospërfshirjen e rezultatit të prodhuar nga kjo QV në tabelën përmbledhëse të Këshillit Bashkiak, qarku Shkodër".

C) Për 3 ankime është vendosur pushimi i gjykimit.

PJESA III – PERIUDHA PASZGJEDHORE

III.1 Auditimi i subjekteve zgjedhore.

Partitë politike duhet të dorëzojnë raportet financiare në KQZ¹⁴. Modeli i këtij raporti dhe afati i dorëzimit të tij janë miratuar me vendimet e KQZ-së¹⁵. Afati i dorëzimit të këtij raporti është data 31 mars e vitit pasardhës. Për vitin kalendarik 2014, nga 125 parti politike të regjistruara në gjykatën e rrethit Tiranë, kanë dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ, vetëm 13 parti politike: Partia Demokratike, Partia Socialiste e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Republikane Shqiptare, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Socialdemokrate, Aleanca Kuq e Zi, Partia Kristiandemokrate e Shqipërisë, Fryma e Re Demokratike, Partia Forca Rinia, Partia Demokracia Sociale, Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 125 parti politike për vitin kalendarik 2014, KQZ përzgjedhi me short dhe emëroi 17 ekspertë kontabël të licensuar¹⁶.

Një ekspert nuk u paraqiti pranë KQZ-së për të lidhur kontratën e shërbimit.

KQZ administroi raportet e auditimit dhe përgatiti një material mbi bazën e opinionit të shprehur në këto raporte nga ekspertët kontabël. Në përfundim të procesit të verifikimit të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2014, rezultoi:

Nga 118 parti politike të cilat duhet të auditoheshin, 71 parti politike nuk u arrit të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga KQZ. Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë nuk është audituar për vitin 2014, pasi është krijuar në vitin 2015. Për 32 parti politike ka deklarata të kryetarit të partisë ose të autorizuarit të tij se partia nuk ka përfutur dhe shpenzuar fonde për vitin 2014. Për 14 parti politike ekspertët kontabël kanë paraqitur një raport të rregullt auditimi, pasi vetëm 14 parti politike kanë përfutur dhe shpenzuar fonde për vitin 2014. Në asnjë nga 14 raportet e auditimit ekspertët kontabël nuk kanë paraqitur vërejtje në lidhje me respektimin e legjislacionit për menaxhimin e fondeve nga ana e partive politike. Raportet e auditimit janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së. KQZ nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të bërë verifikime të mëtejshme në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për qëllime të aktivitetit të tyre vjetor.

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 61 partitë politike të regjistruara si subjekt zgjedhor, apo 26 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, zgjedhjet për Organet e

¹⁴ Ligji nr.10374, datë 10.02.2011 "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

¹⁵ Vendimi i KQZ nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standartizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël".

¹⁶ Vendimi i KQZ nr.969, datë 10.08.2015 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015".

Qeverisjes Vendore, të datës 21 Qershor 2015, KQZ përzgjedhi me short dhe emëroi 22 ekspertë kontabël të licensuar¹⁷. KQZ administroi raportet e auditimit dhe po përgatit një material mbi bazën e opinionit të shprehur në këto raporte nga ekspertët kontabël.

III.2 Analiza e zgjedhjeve

KQZ më datat 5 dhe 6 Nëntor zhvilloi analizën vjetore të veprimtarisë së saj me fokus, "Administrimi i procesit të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 21 Qershor 2015 - Problematikat & Rekomandimet për përmirësimin e tyre".

KQZ, i angazhuar në vijimësi për përmbushjen sa më optimale të misionit institucional dhe detyrimeve ligjore që Kodi Zgjedhor i ngarkon, me përgjegjshmëri dhe frymë kritike, pas daljes së Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet vendore 2015, analizoi në themel ecurinë e procesit zgjedhor në të gjitha fazat ku ai kaloi, *realizimet e arritjet, por krahas* problematikat e evidentuara në Raportin e OSBE/ODIHR, por dhe raporteve të tjera të organizmave ndërkombëtare apo vendase që monitoruan dhe raportuan për procesin zgjedhor të 21 Qershorit 2015.

KQZ bëri pjesë të kësaj analize përfaqësues të partive politike parlamentare dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare si OSBE, Shqipëri, KiE, UN-Ëomen, në kuadër të transperencës por dhe të vendosjes së një bashkëpunimi permanent me përfaqësues të partive politike dhe me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve.

Mbi bazën e informacionit të paraqitur në këtë analizë nga anëtarë të KQZ dhe niveli drejtues i administratës, që trajtuan aspekte të veçanta të ecurisë së procesit zgjedhor, si dhe nga diskutimet e të pranishmëve gjatë zhvillimit të saj, u shpalos një panoramë e përmbledhur, por e plotë, e përgatitjes, organizimit dhe zhvillimit dhe shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, në mbështetje të procedurave ligjore.

Përtej faktit, se çfarë shkoi mirë dhe çfarë mund të ishte bërë ndryshe, në këtë analizë u dhanë ide/sugjerime për përmirësime që mund të konsiderohen sa i përket anës organizative, po ashtu dhe përmirësimeve të mundshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor.

Me mjaft interes u ndoq në këtë analizë edhe trajtimi i temave si "Gjetjet dhe rekomandimet e raportit OSBE/ODIHR-it për procesin zgjedhor" apo "Gjetjet dhe rekomandimet e raportit të Këshillit të Europës për procesin zgjedhor" të trajtuara nga përfaqësuesit e organizatave në këtë analizë.

Sikundër edhe përfaqësuesit e sipërcituar theksuan në diskutimet e tyre, për herë të parë në raportet e vëzhguesve ndërkombëtarë nuk ka asnjë rekomandim për numërimin, që do të thotë, që nuk është gjetur asnjë gjë e qenësishme për tu vendosur si rekomandim, njëherazi u theksua se përmirësime nevojiten pavarësisht se nuk përmenden më.

Në vlerësim të përfundimeve të kësaj analize, e cila fokusoji gjithashtu dhe rolin e rëndësishëm që aktorë të tjerë kanë në procesin zgjedhor, përmbushja e detyrimeve apo bashkëpunim i të cilëve kushtëzon mbarëvajtjen e organizimit dhe menaxhimit të procesit, KQZ evidentoi qartazi nevojën për përmirësime në planin organizativ dhe bashkërendim më i mirë i punëve me aktorë të tjetër, por gjithashtu edhe nevojën për përmirësime të ligjit zgjedhor.

III.3 Strategji të KQZ-së për të ardhmen

1. Zhvillimi i *trajnimeve për administrimin zgjedhor jashtë periudhës zgjedhore dhe në mënyrë periodike për të gjithë të interesuarit.*

Zhvillimi i këtyre trajnimeve **të cilat** mund të jenë të përgjithshme dhe të specializuara për funksione të veçanta të administrimit të zgjedhjeve, synojnë zbatimin e frymës së ligjit për lidhjen/kushtëzimin e trajnimit me angazhimin në procesin administrativ zgjedhor si

¹⁷ vendimi i KQZ nr.969, datë 10.08.2015 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015".

komisioner i çdo niveli, krijimin e mundësive për trajnimin e të gjithë aktorëve/grupeve të përfshira në zgjedhje (*media, administratë e pushtetit vendor, vëzhgues*).

Realizimi i sesioneve të trajnimit zgjedhor në periudhën jashtëzgjedhore, vjen jo vetëm në përmbushje të kompetencës së KQZ-së, përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, por i shërben krijimit të kontigjenteve të burimeve njerëzore të mirë trajnura të cilat mund të përdoren nga partitë politike në ushtrim të të drejtës së tyre ligjore për lirim/zëvendësim komisionerësh të nivelit të II-të, do të përbëjnë kontigjentin për emërimet kryesisht nga KQZ/KZAZ, për rastet e parashikuara në ligj, për trajnimin e mediave (kombëtare dhe lokale) me qëllim kuptueshmërinë e etapave/procedurave ligjore për të pasqyruar dinamikat/ecurinë e procesit zgjedhor në mënyrë korrekte, si dhe për trajnimin e nëpunësve të administratave vendore për detyrat e rëndësishme që i përcakton Kodi Zgjedhor.

Këto trajnime jashtëzgjedhore, do të zhvillohen nga administrata e KQZ-së, në të gjithë qarqet e vendit, sipas një kalendari të hartuar paraprakisht. Koha, vendi dhe temat që do të trajtohen do të bëhen publike me qëllim gjithëpërfshirjen e target grupeve të ndryshme, që në procesin zgjedhor mund të angazhohen në role dhe detyra të ndryshme.

Sigurimi i sallave/ambienteve dhe pajisjeve të tjera të nevojshme logjistike do të realizohet, sikundër në vitin 2014, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor.

Suksesi i kësaj veprimtarie do të ndikohet nga fakti se KQZ tashmë ka në dispozicion Sallën e Trajnimeve, një ambient i ri institucional me parametra bashkëkohorë.

2.Zhvillimi i programeve të edukimit zgjedhor të shtetasve

Programet e edukimit zgjedhor do të synojnë forcimin e kulturës zgjedhore tek të gjithë shtetasit, duke fokusuar praktikën e gabuara zgjedhore si ndikimi i vullnetit të votuesit (shit-blerja e votës dhe votimi familjar).

Janë strukturuar dhe do të realizohen programe të edukimit zgjedhor të përshtatura për specifikat dhe nevojat e komunitetit rom, në vlerësim edhe të rekomandimit të raportit të OSBE/ODIHR.

Objektivat e synuar:

- a) Ndërgjegjësimi/edukimi i votuesve për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje;
- b) Ndërgjegjësimi i votuesve për të dënuar/denoncuar fenomenin e shit-blerjes së votës;

3.Bashkëpunimi permanent me partnerët ndërkombëtarë, asistencë, monitorimi dhe angazhimi i tyre në procesin zgjedhor, dhe post zgjedhor ka qenë jo vetëm një mbështetje e madhe në punën e KQZ-së, por dhe kanë ndihmuar në ngritjen profesionale të institucionit të KQZ-së dhe standardin e zgjedhjeve në vite.

Në këtë kontekst, KQZ ka paraqitur një numër të konsiderueshëm projekt-ide (duke i vlerësuar dhe ndarë ato sipas rëndësisë në prioritare dhe sekondare), në funksion të strategjive të reja që duhet të ngrejë dhe zhvillojë KQZ për arritjen e standarteve të kërkuara për zgjedhjet e radhës.

Kryesisht projekt-ide lidhen me përfundimin e ndërtimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit Zgjedhor IEMIS (Integrated Elections Management Information System) me të gjitha modulet (module për t'u përfunduar, module të planifikuara për t'u zhvilluar), me trajnimin e personave të interesuar kontigjent për komisionere zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për veprat penale në zgjedhje, si shit-blerja e votës, falsifikimi i materialeve apo rezultateve zgjedhore,

Module të përfunduar ose në proces për t'u përfunduar:

- Moduli për menaxhimin e funksioneve në ditën e zgjedhjeve (hapja e votimit, pjesëmarrja në orë të caktuara, bllokimi eventual i votimit, mbyllja e votimit). Nga QV-të në KZAZ aktualisht jepet informacion me mesazh zanor (celular), nga KZAZ në KQZ transmetim elektronik via-ëeb me aplikacion (synohet në të ardhmen edhe QV-të të pajisen me mjete për transmetim të njëjtë).

- Moduli për menaxhimin e procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, verifikimi dhe vlefshmëria e të drejtës të kandidatëve për të kandiduar, publikimi në internet. Synohet që aplikimi për regjistrimin në zgjedhje të subjekteve të bëhet online.
- Moduli "Konsolidimi i rezultateve" ku menaxhohet hedhja, kontrolli dhe transmetimi i rezultateve nga Vendi i Numërimit të Votave (VNV) në KQZ.
- Moduli "Rezultatet e natës së zgjedhjeve" (Election night results), nëpërmjet të cilit publikohet në dinamik rezultatet paraprake të zgjedhjeve në sallën e mediave në KQZ dhe në faqen e internetit.
- Modul për administrimin e informacionit për financimin dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore të subjekteve zgjedhore. Në proces synohet që raportimi i subjekteve zgjedhore të bëhet online, raportet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, të mundësohet trainimi edhe i financierëve të partive dhe auditëve për këtë modul.
- Hartat zgjedhore me informacione të ndryshme edhe në faqen e KQZ-së, synohet të zhvillohet duke përdorur teknologjinë Eeb-GIS (Eeb- Geographic information system).

Module të planifikuara për t'u zhvilluar,

- Moduli për menaxhimin e fletës së votimit, zgjedhjet rastësore në renditje, dizajnimi i fletës së votimit dhe përgatitja për tu printuar;
- Moduli për menaxhimin e informacionit për ndarjet administrative dhe zgjedhore (qark, bashki, zona të administrimit zgjedhor, vende të numërimit të votave dhe qendrave të votimit);
- Moduli për menaxhimin e të dhënave për administratën zgjedhore;
- Moduli për menaxhimin buxhetor/financiar për komisionet e nivelit të dytë;
- Modulet për shpërndarjen e mandateve dhe historinë e tyre;
- Modulet për përgatitjen e raporteve për buletin zgjedhor.

III.4 Sugjerime për përmirësime në Kodin Zgjedhor, nisur nga problematikat e hasura në zgjedhje.

Raporti i OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet vendore 2015, krahas vlerësimit të procesit zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së, obligimet e tjera ndërkombëtare dhe standartet demokratike për zgjedhjet, si dhe me legjislacionin kombëtar, adresoi ndër rekomandimet prioritare "Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet në mënyrë që të eliminohej mangësitë dhe paqartësitë e identifikuara në këtë raport dhe ato të mëparshme të OSBE/ ODIHR-it".

KQZ, në vlerësim të këtij rekomandimi, në frymën e Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR 2015, eksperiencës institucionale dhe analizës së punës, ka përgatitur një paketë me sugjerimet për ndryshime dhe përmirësime të Kodit Zgjedhor.

KQZ gjithashtu risjell në vëmendje, çështje të tjera, objekt i diskutimeve gjithëpërfshirëse në tryezat teknike të organizuara nga KQZ me mbështetjen e OSBE përgjatë vitit 2014, dhe që si paketë propozimesh i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë për t'u vlerësuar dhe materializuar në Kodin Zgjedhor, por që vijnë të mbeten të patrajtuara. Këtë paketë, të rivlerësuar pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të 2015, KQZ-ja do t'ia përcjellë Komisionit të Reformës Zgjedhore.

KQZ, me asistencën dhe ekspertizën e partnerëve ndërkombëtarë KE dhe OSBE, ka draftuar ndryshimet e nevojshme ligjore për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit dhe Edukimit Zgjedhor, të cilat do të paraqiten në një material të zgjeruar.

KQZ, vlerëson se përcjellja e këtyre propozimeve Komisionit të Reformës Zgjedhore, përmbush një nga rekomandimet e rëndësishme të OSBE/ODIHR-it të vitit 2011, që në diskutimin mbi reformën zgjedhore duhet të përfshihen jo vetëm partitë politike, por gjithashtu dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), autoritetet përkatëse shtetërore dhe grupet e interesit.

Sa më sipër, shprehim besim plotë për vëmendjen Tuaj ndaj sugjerimeve dhe rekomandimeve të paraqitura, me synim përmirësimin e ligjit zgjedhor në reformën zgjedhore duke synuar arritjen e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht për proceset zgjedhore të ardhshme

IV- VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË

IV.1 Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Duke qenë se zgjedhjet në Shqipëri, kanë ndikim të drejtëpërdrejtë për konsolidimin e demokracisë, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë për të ardhmen dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian, sigurisht për realizimin e tyre me sukses dhe me standartet të gjithëpranuara, kërkon bashkëpunimin dhe ndërveprim të shumë institucioneve të tjera.

Bashkëpunimin, KQZ e ka ngritur në nivel institucional, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, me institucione të tjera të shtetit shqipëtar, veprimtaria e të cilave është vendimtare për arritjen e suksesit.

KQZ-Këshilli i Ministrave

Kur themi bashkëpunim me Këshillin e Ministrave kemi parasysh detyrimet ligjore që kanë disa ministri apo digastere qendrore për ecurinë e procesit zgjedhor, dhe përgjegjësinë e qeverisë për të organizuar e bërë zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike.

Të bindur se për realizimin standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm midis KQZ dhe strukturave shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë; me qëllim përmbushjen në shkallë institucionale të këtij bashkëpunimi, KQZ dhe Këshilli i Ministrave lidhën Memorandum Bashkëpunimi "Për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që u zhvilluan në datë 21.06.2015".

KQZ shpreh falenderime për të gjithë institucionet shtetërore, që treguan frymë të lartë bashkëpunimi për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit, dhe në veçanti për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Arsimit, falë të cilit u garantuan:

1. Sigurimin e ndërtesave publike të nevojshme për krijimin e selive të KZAZ-ve, Qendrave të Votimit, dhe Vendeve Numërimit të Votave;
2. Sigurimin e ndërtesave publike të nevojshme për Zyrat Rajonale Zgjedhore të KQZ-së.
3. Sigurimin e ndërtesave publike të nevojshme, për realizimin e trajnimeve për komisionerët e niveleve të dyta dhe të treta dhe anëtarët e grupeve të numërimit.
4. Transportin e bazës materiale zgjedhore, nga KQZ-ja në KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas.

KQZ-OSHEE

Për krijimin e kushteve sa më optimale lidhur me furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të godinave të objekteve zgjedhore, KQZ dhe OSHEE lidhën Marrëveshje Bashkëpunimi.

OSHEE meri përsipër të furnizojë me energji elektrike nëpërmjet linjave të tij, në mënyrë të pandërprerë, të gjitha objektet zgjedhore në të gjithë territorin e vendit, si më poshtë:

1. Godina e KQZ (Pallati i Kongreseve Tiranë) gjatë gjithë periudhës zgjedhore;
2. Godinat e magazinave në fshatin Lundër, Tiranë gjatë gjithë periudhës zgjedhore,
3. Godinat e KZAZ-ve dhe Vendet e Numërimit të Votave në të gjithë territorin e vendit nga ora 07:00 e datës 18 qershor 2015 deri në nxjerrjen e tabelave përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për secilin organ të qeverisjes vendore, nga KZAZ-ja dhe dorëzimin e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore në KQZ.

OSHEE eliminoi brenda një kohe të arsyeshme, defektet në linjat e furnizimit gjatë kësaj periudhe në këto objekte, nëpërmjet punonjësve të saj në drejtoritë rajonale.

KQZ-Autoriteti i Mediave Autovizive

Në zbatim të nenit 85 të Kodit Zgjedhor, për përcaktimin e rregullave, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve teknike dhe njerëzore të AMA-së, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, në funksion të zgjedhjeve për

Organet e Qeverisjes Vendore datë 21.06.2015, KQZ dhe AMA, lidhën një Marrëveshje Bashkëpunimi.

Autoriteti i Mediave Audiovizive siguroi :

a. Studion e monitorimit në dispozicion të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) me pajisjet teknike për monitorim, si dhe personelin teknik dhe monitorues përkatës, nga momenti i ngritjes së Bordit të Monitorimit të Medias, deri në raportimin e fundit të tij në KQZ, pas përfundimit të periudhës së fushatës zgjedhore.

b. Ambiente të mjaftueshme në dispozicion të BMM për kryerjen e monitorimit.

c. Regjistrimin e programeve në mënyrë dixhitale për 15 (pesëmbëdhjetë) operatorë televizivë. Për regjistrimin e programeve të transmetuara nga operatorët radio e televizivë regjistrime me sondazhe për ato subjekte, sinjali i të cilave arriti në Studion e Monitorimit të AMA-së.

KQZ-Prokuroria e Përgjithshme

Duke marrë parasysh faktin se për integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, parandalimi dhe ndëshkimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ka një rëndësi të madhe, duke qenë se për realizimin e standardeve kërkohet bashkëpunim i vazhdueshëm KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, lidhën Marrëveshje Bashkëpunimi.

Qëllimi kryesor i bashkëpunimit ndërinstitucional, zhvillimi i fushatave sensibilizuese/edukuese dhe sesioneve trajnuese për eliminimin e praktikave negative dhe identifikimin e shkeljeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme realizuan dhe më pas u transmetua në disa media spoti televiziv për ndërgjegjësimin dhe parandalimin veprave penale në lidhje me zgjedhjet.

KQZ, gjatë vitit 2015 ka nënshkruar gjithashtu disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe në vende të tjera si KQZ e Kosovës dhe Autoriteti Permanged Elektoral i Rumanisë.

Me nënshkrimin e këtyre memorandumeve synohet shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimi në fushën e administrimit të zgjedhjeve, për të bërë të mundur ngritjen e kapaciteteve reciproke në realizimin e zgjedhjeve.

IV.2 Partneriteti, KQZ-Organizma Ndërkombëtare

Në kuadër të transparencës, por dhe të vendosjes së një bashkëpunimi permanent me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve, KQZ është pjesë e një grupi pune i krijuar me iniciativën e OSBE-së që materializohet në takimin mujor të punës me Election Eörking Group (EËG), praktikë pune kjo tashmë e konsoliduar.

Në këtë vit zgjedhor janë mbajtur gjithsej 10 takime pune, të zhvilluara një herë në muaj në periudhë parazgjedhore dhe duke u intesifikuar në periudhën zgjedhore.

Vetë titullarja e institucionit ka qenë prezente në organizimin e këtyre takimeve ku rregullisht ka informuar të pranishmit lidhur me veprimtarinë e KQZ-së, problematikat dhe sfidat e ndeshura gjatë punës dhe ka kërkuar dhe mbështetjen e tyre në trajtimin e problemeve.

Mbështetja e komunitetit ndërkombëtar ka konsistuar në organizimin e tryezave teknike si tryeza e miratimit të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KQZ-së me mbështetjen e Këshillit të Evropës, në përmbushjen me sukses nga ana e KQZ-së të detyrave të ngarkuara me ligj, për rritjen në maksimum të besimit të zgjedhësve në integritetin e procesit.

Mbështetja me ekspertizë të huaj dhe ngritja e kapaciteteve të administratës zgjedhore në këtë vit zgjedhor u mundësua nga UNDP dhe USAID. Në kuadër të plotësimit të Sistemit të

Integruar të Administrimit të Informacionit Zgjedhor (IEMIS), me mbështetjen financiare të UNDP-së, KQZ zhvilloi modulën (program kompjuterik) për financimin e partive politike. Njëpërmjet këtij moduli do të bëhet i mundur grumbullimi i gjithë informacionit ligjor që ka të bëjë me procesin e financimit të partive politike dhe të prodhohen në vazhdim raportet e nevojshme ku pasqyrohen problematikat përkatëse.

Me mbështetjen e UNDP-së u zhvillua dhe moduli për administrimin e subjekteve zgjedhore që nga momenti i regjistrimit në KQZ deri në paraqitjen e kandidaturave për kryetar dhe për listat shumëmemorore për këshilltarë. Ky aplikacion veç të tjerash, i ofron informacion publikut për listat shumëmemorore dhe kandidatët për kryetarë të regjistruar në të gjitha bashkitë nga të gjitha subjektet zgjedhore në faqen e internetit të KQZ-së.

Ndërsa mbështetja teknike e USAID-it për KQZ-në në fushën e IT-së u përqëndrua në modulet e zhvilluara deri tani, për administrimin e informacionit për zgjedhjet vendore, në përditësimet e këtyre moduleve në dritën e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor.

Organizimi i seminarëve për ngritjen e kapaciteteve të stafit të KQZ-së u mundësua me mbështetjen e UNDP dhe Unëomen.

Përfshirja në këto trajnime e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në procesin zgjedhor synonte në gjetjen e rrugëve për t'a bërë procesin zgjedhor sa më gjithëpërfshirës si dhe në rritjen e mundësive për gratë jo vetëm si candidate, por edhe si zyrtare zgjedhore si votuese si vëzhguese, etj. Gjithashtu dhe roli mjaft i rëndësishëm i Kolegjit Zgjedhor i cili jep vendimin final lidhur me zgjidhjen e ankimeve zgjedhore ishte fokusi i një programi tjetër trajnime ndërmjet përfaqësuesve të Kolegjit Zgjedhor dhe KQZ-së.

IV.2.1 Vëzhgimi i proceseve zgjedhore

Ndarja e eksperiencave pozitive në trajtimin e mjaft problematikave me të cilat përballen sot Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë me synim shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimave pozitivë ka qenë dhe fokusi i disa aktiviteteve të zhvilluara si vijon:

- Seminare të zhvilluara midis KQZ Shqipëri dhe KQZ Slloveni mbi "Forcimin e pavarësisë së Trupave Zgjedhore" me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Sllovenisë dhe Departamentit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Sllovenisë më 2-3 mars dhe 6 tetor 2015.

- Vizitë studimore për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Finland më 19 Prill 2015, me mbështetjen financiare të Këshillit të Evropës.

- Pjesëmarrja në Simpoziumin e 11-të ndërkombëtar për çështjet zgjedhore e mbështetur financiarisht nga ICSP (Qendra Ndërkombëtare për Studime Parlamentare) më 12-14 Nëntor, 2015 në Meksikë.

- Pjesëmarrje në Trajnimin e specializuar "Roli i Trupave të menaxhimit zgjedhor në sistemin e partive politike" organizuar dhe mbështetur financiarisht nga Instituti Kombëtar i Zgjedhjeve në Meksikë (INE) dhe KQZ në 9-13 Nëntor 2015

- Ndjekja e Programit Ndërkombëtar pilot për zgjedhjet dhe implementimin e kutive të votimit me skaner optik në 01 -07 Tetor 2015 mbështetur nga Shoqata e Zyrtarëve Zgjedhor Botëror (A-ËEB).

- Konferenca e 2-të Botërore e A-ËEB lidhur me rolin dhe sfidat e Trupave Zgjedhore për të siguruar integritet në zgjedhje mbajtur më 18-21 gusht, 2015 në Republikën Domenikane mbështetur nga Shoqata e Zyrtarëve Zgjedhor Botëror (A-ËEB).

IV.2.2 Përfaqësimi i KQZ-së në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore

Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare i ka shërbyer shkëmbimit të eksperiencave dhe ka rritur dhe më shumë vlerësimin për KQZ-Shqipëri, duke zhvilluar imazhin dhe reputacionin e saj në planin rajonal, evropian dhe më gjerë ku vlen për t'u theksuar zgjedhja e KQZ-Shqipëri në:

Bordin Ekzekutiv të A- WEB.

Bordi Ekzekutiv është një strukturë mjaft e rëndësishme e A-WEB i cili garanton një përfaqësim sa më të balancuar të vendeve duke patur në përbërjen e tij anëtarë të cilët janë kryetarë të Trupave të Menaxhimit Zgjedhorë. Kryetarja e KQZ Shqipëri zj.Lefterije Luzi u zgjodh anëtare e Bordit Ekzekutiv në gusht të 2015 duke e çuar në dy numrin e vendeve anëtare për Evropën.

Anëtarët e Bordit Ekzekutiv janë të ftuar të japin vlerësimet e tyre lidhur me veprimtarinë e shoqatës si dhe të shfaqin opinionet e tyre lidhur me strategjitë e sukseshme të cilat do ndiqen në të ardhmen për administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në të gjitha vendet anëtare përfshirë dhe Shqipërinë.

IV.2.3 Konferenca e 25-të e ACEEEO, shtator 2016, Tiranë (KQZ merr Presidencën e radhës të ACEEEO).

Me ftesë të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europianë (ACEEEO), dhe me mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së dhe KiE në Shqipëri, në kuadër të zhvillimit të Konferencës së 24-të Vjetore dhe Takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europianë (ACEEEO), e cila zhvilloi punimet në datat 8-11 Shtator në Moldavi, mori pjesë në cilësinë e anëtarit edhe delegacioni i KQZ-së .

KQZ e Shqipërisë është një nga vendet themeluese dhe anëtare të ACEEEO-s dhe konferenca vjetore është aktiviteti më i rëndësishëm i saj në bashkërendimin e projekteve dhe nismave zgjedhore si dhe në ngritjen profesionale të zyrtarëve zgjedhorë të shteteve pjesëmarrëse. Gjatë sesioneve plenare të Konferencës, Kryetarja e KQZ-së, referoi para trupave zgjedhorë rajonal dhe ndër-rajonal dhe eksperiencën shqiptare mbi edukimin zgjedhor dhe trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në këtë proces.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme u votua për presidencën e radhës së ACEEEO-s, ku me vendim unanim nga të gjithë anëtarët e bordit u zgjodh Kryetarja e KQZ-së, zj.Lefterije Luzi si Presidentja e ardhshme e ACEEEO-s (2015-2016).

Zhvillimi i konferencës vjetore në Tiranë konsiderohet një ngjarje shumë e rëndësishme në rrafshin politik dhe atë ndërkombëtar të Shqipërisë. Kryesimi i një organizate ndërkombëtare me një nivel të lartë përfaqësimi, siç është ACEEEO, nga një përfaqësues shqiptar, përbën një moment të rëndësishëm dhe të shumëpritur për procesin e integritetit dhe arritjen e standarteve ndërkombëtare zgjedhore. Është e padiskutueshme që zhvillimi i një konference të tillë në Tiranë është një rast shumë i mirë për të treguar një imazh pozitiv të vendit tonë dhe të administratës së tij në veçanti.

Së fundmi,

Në vështrimin e anëtarësisë së KQZ-së dhe eksperiencës së saj në zgjedhje, jemi të mendimit se nuk ka zgjedhje të përkryera, me ndryshimin e praktikave dhe taktikave për ti fituar zgjedhjet nga partitë politike, ndryshojnë dhe problemet nga një proces zgjedhor në tjetrin.

Administrimi i procesit zgjedhor është përmirësuar nga zgjedhjet në zgjedhje, proces i rregullt votimi dhe numërimi të votave, është rritur cilësia dhe siguria e materialeve zgjedhore, njëherazi është rritur besimi i elektoratit tek procesi zgjedhor.

Pavarësisht përmirësimit që mund ti bëhen Kodit Zgjedhor, për të garantuar zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike duhet vullneti i mirë i forcave politike dhe i administratës zgjedhore.

Gjithsesi, duke vlerësuar raportin e OSBE/ODIHR, raportet të tjera të organizmave ndërkombëtare apo vendas, që monitoruan dhe raportuan për procesin zgjedhor të 21 Qershorit 2015, në pritje të vlerësimit dhe rekomandimet Tuaja për veprimtarinë në vijim, KQZ mbetet i angazhuar për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, të drejtën kushtetuese të votës, lirinë dhe barazinë e saj!

Aneksi 1

Tabele 1

Shpërndarja si paradhënie e fondit publik partive politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015

NR.	EMËRTIMI I PARTISE POLITIKE	FONDI QË PËRFITOHET
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	18,120,554
2	Partia Demokratike	13,855,542
3	Lëvizja Socialiste për Integrim	4,927,917
4	Partia Republikane	3,089,960
5	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2,655,391
6	Partia Demokracia Sociale	2,227,395
7	Partia Demokristiane e Shqipërisë	2,006,636
8	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	1,834,902
9	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	1,704,364
10	Partia Lëvizja e Legalitetit	1,583,873
11	Aleanca Demokratike	1,375,465
12	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	1,290,560
13	Partia Bashkimi Liberal Demokrat	1,123,180
14	Partia Socialiste e Vërtetë 91	988,749
15	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	889,736
16	Partia Balli Kombëtar	875,920
17	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	844,771
18	Partia Balli Kombëtar Demokrat	650,220
19	Partia G99	639,084
20	Aleanca Arbnore Kombëtare	386,297
21	Partia e Gjelbër	353,684
22	Partia Ligj dhe Drejtësi	325,801
23	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	83,333
24	Aleanca Popullore	83,333
25	Partia Mendimi Djathtë Liberal	83,333
26	Partia e Punës e Shqipërisë	83,333
27	Partia Unitetit Kombëtar	83,333
28	Partia Shqiptare Atdheu	83,333
29	Partia e Pajtimit Kombëtar	83,333
30	Partia Komuniste e Shqipërisë	83,333
31	Partia Rruga e Lirisë	83,333
32	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	83,333
33	Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane	83,333
34	Partia e Çështjeve Shqiptare	83,333
35	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	83,333
36	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	83,333
37	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	83,333
38	Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve	83,333
39	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	83,333
40	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	83,333
41	Partia Ardhmëria Shqiptare	83,333
42	Partia Socialiste e Moderuar	83,333
43	Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim	83,333
44	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	83,333
45	Partia Demokracia e Re Europiane	83,333
46	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	83,333
47	Partia e të Drejtave të Mohuara	83,333
48	Partia Ora e Shqipërisë	83,333

49	Partia e të Drejtave të Mohuara e Re	83,333
50	Partia Konservatore Shqiptare	83,333
51	Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian	83,333
52	Fryma e Re Demokratike	83,333
53	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorëve të Shqipërisë	83,333
54	Aleanca Europiane Ekologjike	83,333
55	Partia Bashkimi Demokrat	83,333
56	Partia Demokrate e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë	83,333
57	Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë	83,333
58	Partia Forca Rinia	83,333
59	Lëvizja Demokratike për Vlera Mirëqënie Progres	83,333
60	Partia Fronti i Majtë	83,333
61	Partia Socialpunëtore Shqiptare	83,333
	TOTALI	65.000.000

Tabele 2

Rishpërndarja e fondit publik pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, partive politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015

NR.	EMËRTIMI I PARTISE POLITIKE	FONDI QË PËRFITOHET
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	18,185,705
2	Partia Demokratike	14,343,219
3	Lëvizja Socialiste për Integrim	11,738,210
4	Partia Republikane	2,428,801
5	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2,696,003
6	Partia Demokracia Sociale	906,059
7	Partia Demokristiane e Shqipërisë	915,406
8	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	1,007,936
9	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	667,035
10	Partia Lëvizja e Legalitetit	623,728
11	Aleanca Demokratike	514,445
12	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	605,123
13	Partia Bashkimi Liberal Demokrat	584,756
14	Partia Socialiste e Vërtetë 91	788,692
15	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	887,092
16	Partia Balli Kombëtar	638,405
17	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	386,511
18	Partia Balli Kombëtar Demokrat	637,456
19	Partia G99	428,553
20	Aleanca Arbnore Kombëtare	571,119
21	Partia e Gjelbër	461,564
22	Partia Ligj dhe Drejtësi	391,524
23	Partia Unitetit Kombëtar	455,107
24	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	425,573
25	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	359,145
26	Partia Socialiste e Moderuar	693,408
27	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	406,787
28	Partia Ora e Shqipërisë	485,227
29	Fryma e Re Demokratike	1,354,030
30	Partia Bashkimi Demokrat	413,380
	TOTALI	65.000.000

Aneks 2

Parti pjesëtare të Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015

1. Partia Demokratike,
2. Partia Republikane,
3. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë,
4. Partia Lëvizja e Legalitetit,
5. Partia Balli Kombëtar,
6. Partia Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar,
7. Partia Bashkimi Liberal Demokrat,
8. Partia Balli Kombëtar Demokrat,
9. Partia Ora e Shqipërisë,
10. Partia Bashkimi Demokrat,
11. Partia Mendimi Djathtë Liberal,
12. Partia e të Drejtave të Mohuara e Re,
13. Partia Konservatore Shqiptare,
14. Partia Popullore Kristian Demokrate,
15. Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare

Parti pjesëtare të Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21.06.2015

1. Partia Socialiste e Shqipërisë,
2. Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim,
3. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet,
4. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare,
5. Partia Aleanca Demokratike,
6. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European,
7. Partia Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane,
8. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet,
9. Partia Ardhmëria Shqiptare,
10. Partia Demokracia e Re Europiane,
11. Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë,
12. Partia e Çështjeve Shqiptare,
13. Partia e Gjelbër,
14. Partia e Punës e Shqipërisë,
15. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare,
16. Partia e të Drejtave të Mohuara,
17. Partia Forca Rinia,
18. Partia e Unitetit Kombëtar,
19. Partia G99,
20. Partia Komuniste e Shqipërisë,
21. Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori,
22. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim,
23. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve,
24. Partia Ligj dhe Drejtësi,
25. Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë
26. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve,

27. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar,
28. Partia Rruga e Lirisë,
29. Partia Shqiptare Atdheu,
30. Partia Socialiste e Moderuar,
31. Partia Socialiste e Vërtetë 91,
32. Partia Socialpuntore Shqiptare,
33. Partia Fryma e Re Demokratike,
34. Partia Demokracia Sociale,
35. Partia Demokristiane e Shqipërisë,
36. Partia Aleanca Demokristiane.
37. Partia Pajtimi Kombëtar

Parti politike që nuk ishin pjesë e ndonjë koalicioni por kandiduan me vete, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21.06.2015

1. Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë
2. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
3. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
4. Partia Aleanca Kombëtare
5. Partia Aleanca Ekologjike
6. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
7. Partia Lëvizja Demokratike për Vlera Mirëqenie Progres
8. Partia Fronti i Majtë
9. Partia Aleanca Popullore

Kandidatë për anëtar këshilli të mbështetur nga zgjedhësit, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21.06.2015

Nr.	Qarku	Bashkia	Emri	Mbiemri
1	DIBER	DIBER	AGIM	GJONI
2	DIBER	DIBER	ASTRIT	ADEMI
3	ELBASAN	ELBASAN	ILIRJAN	SADIKU
4	KORCE	KORCE	AGIM	KAÇANI
5	KUKES	KUKES	ARMANDO	GJOKA
6	KUKES	KUKES	LAVDRIM	SHEHU
7	LEZHE	LEZHE	GJERGJ	NDREKA
8	LEZHE	MIRDITE	LUAN	FUFI
9	LEZHE	MIRDITE	GJON	PJETRI
10	LEZHE	MIRDITE	MADALENA	NIKOLLI
11	TIRANE	KAMEZ	GJERGJ	PALUCA
12	TIRANE	KAMEZ	EDMOND	NDOJ

Kandidatë për kryetar bashkie të mbështetur nga zgjedhësit, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21.06.2015

Nr.	Qarku	Bashkia	Emri	Mbiemri
1	DIBER	DIBER	ILIR	BULKU
2	ELBASAN	BELSH	BESJON	TAFANI
3	GJIROKASTER	DROPULL	HRISTO	DUCI
4	GJIROKASTER	KELCYRE	BUJAR	FEZGA
5	GJIROKASTER	MEMALIAJ	ASTRIT	DERVISHI
6	GJIROKASTER	MEMALIAJ	ORGEN	HASANBEGA
7	GJIROKASTER	TEPELENE	DRITAN	MEMUSHI
8	KORCE	POGRADEC	LLAZI	DETI
9	KUKES	TROPOJE	AGRON	DEMUSHI
10	TIRANE	TIRANE	GJERGJ	BOJAXHI
11	VLORE	HIMARE	VLADIMIR	KUMI
12	VLORE	KONISPOL	FATMIR	SHERO
13	VLORE	SELENICE	ALMA	GOLEMAJ
14	VLORE	VLORE	VASIL	BEDINAJ

Të dhëna përmbljedhëse

	Gjithsej	%	femra		meshkuj	
			gjithsej	%	gjithsej	%
Zgjedhës në listën e zgjedhësve	3.372.471		1.667.787	49,45%	1.704.684	50,55%
Pjesmarrës në zgjedhje	1.613.054	47,83%	693.371	46,62%	794.041	53,38%
Vota të pavlefshme për kryetar	38.545	2,39%	Shënim: Për 423 qendra votimi mungojnë të dhënat për treguesin gjinor për pjesmarrjen në zgjedhje.			
Vota të vlefshme për kryetar	1.573.369	97,53%				
Fletë votimi të hedhura gabim për kryetar	1.252	0,08%				
Vota të pavlefshme për këshill	49.766	3,08%				
Vota të vlefshme për këshill	1.562.161	96,84%				
Fletë votimi të hedhura gabim për këshill	1.280	0,08%				
Qendra Votimi	5.301					